

NA ISHTE

NJË

HERË

QË

KURRË MOS

QOFTË

Ky katalog është botuar për  
të dokumentuar ekspozitën  
'Na ishte një herë që kurrë mos qoftë'  
13 maj 2019

Qendra e Dokumentimit Kosovë (QDK),  
Biblioteka e Qytetit 'Hivzi Sulejmani',  
Dardani, 10000 Prishtinë, Kosovë

Realizuar nga  
Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

Kuruar nga  
Blerta Hoçia

Ekipa e Ekspozitës  
Dea Dedi  
Vesa Qena

Arkitektura e Ekspozitës  
Ardea Krasniqi  
Lirika Krasniqi

Dizajni Grafik  
Nita Salihu Hoxha-Permanent

Fotografitë profesionale  
në ekspozitë nga  
Andrew Testa  
Sali Beqaj  
Visar Kryeziu  
Yannis Behrakis  
Arben Celi  
Pawel Kopczynski  
Hazir Reka

Mbështetur nga  
National Endowment for Democracy (NED)  
Komuna e Prishtinës  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

[hlc-kosovo.org](http://hlc-kosovo.org)



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë  
Fond za humanitarno pravo Kosovo  
Humanitarian Law Center Kosovo

DCKK



National Endowment  
for Democracy  
Supporting freedom around the world



PRISHTINA



MKRS/MCYS

HYRJE

Fondi për të Drejtën  
Humanitare Kosovë (FDHK)

6-11

Blerita Hoçia  
Kuratore

12-15

TEKSTI KURATORIAL

EKSPOZITA

Muri i Emrave 1998-2000 17  
Dhoma e Errët / Rrëfimi i Gramoz Berishës 18  
Dhoma e Xhamit 22  
Gjësendet e Fëmijëve 34  
Muri i Portreteve 144

17-151

<sup>4</sup> RRË<sup>5</sup>FIMET

Imer Deliu 154  
Rrahime dhe Enver Lipaj 158  
Zorica dhe Dragiša Petrović 164  
Isak Asllani 170

152-173

Fotografia si pjesë e historisë  
Hazir Reka

174-179

FOTOGRAFI

Jo një viktimë pasive:  
Rrëfimi i 1133 fëmijëve  
Erëmirë Krasniqi

180-185

RECENSION EKSPOZITE

Fondi për të  
Drejtën Humanitare  
Kosovë (FDHK)

HYRJE

6

7

01

Të gjitha aktivitetet e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) lidhen me fushën e Drejtësisë Tranzicionale me qëllim të kontribuimit në: arritjen e drejtësisë për viktimat, vendosjen e rrëfimit të saktë për luftën, mbështetjen e familjarëve për të drejtën e tyre në dëmshpërblime si dhe edukimin e të rinjve në fushën e Drejtësisë Tranzicionale. Kohët e fundit, FDHK kontribuon edhe në memorializimin e viktimave të luftës.

8

9

Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) është organizatë joqeveritare për të drejtat e njeriut e themeluar në vitin 1992 nga znj. Natasha Kandiç, me qëllim që t'i dokumentojë shkeljet serioze të të drejtave të njeriut që po kryheshin gjatë konflikteve të armatosura në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë.

Në kulmin e represionit policor, torturës, ndalimeve të paligjshme dhe gjykimeve politike ndaj shqiptarëve të Kosovës, në vitin 1997, FDH hapi degën në Prishtinë. Me fillimin e luftës në Kosovë, zyra e Fondit për të Drejtën Humanitare vazhdoi punën në dokumentimin e vrasjeve dhe zhdukjeve të shqiptarëve dhe grupeve të tjera etnike në Kosovë, aktivitet i cili u intensifikua edhe pas përfundimit të luftës.

Përveç punës në këtë projekt, i cili më vonë emërohet si "Libër Kujtimi i Kosovës", FDH fillon që të monitorojë në mënyrë sistematike të gjitha proceset gjyqësore për krime lufte dhe për krime të motivuara etnikisht dhe politikisht.

Nga viti 2000 monitoruesit e FDH kanë qenë prezent në secilën seancë gjyqësore për këto krime e që janë zhvilluar para gjykatave në Kosovë. Që nga ajo kohë, FDH ka mbledhur dokumentacionet gjyqësore për këto

vepra penale, dokumentacion i cili është arkivuar në arkivin e FDH-së. Çdo vit FDH publikon raportin vjetor mbi këto procese si dhe publikon analizat e proceseve gjyqësore që kanë përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm.

Nga viti 2001 deri në vitin 2013, FDH ka zbatuar projektin "Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Bashkësive Etnike në Kosovë", në kuadër të së cilit projekt është bërë dokumentimi i incidenteve ndëretnike që kanë ndodhur në atë periudhë. Gjithashtu është hulumtuar dhe raportuar mbi lirinë e lëvizjes së pjesëtarëve të pakicave etnike si dhe mbi zbatimin e kornizës ligjore mbi të drejtat e pakicave etnike në Kosovë. Një segment i këtij projekti ka qenë edhe monitorimi i procesit të kthimit të të zhvendosurve.

Në vitin 2011, zyra e FDH në Prishtinë u regjistrua si organizatë e pavarur nën emrin Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK). FDHK vazhdon të bashkëpunoj ngushtë me FDH me seli në Beograd, në disa projekte, siç janë Libër Kujtimi i Kosovës, Nisma për KOMRA-n etj. Në ndërkohë, FDHK zhvillon edhe projekte tjera, ndër të cilat vlen të theksohen Edukimi Jo-formal i të Rinjve mbi Drejtësinë Tranzicionale.

Ekspozita 'Na ishte një herë që kurrë mos goftë' është dedikim për të gjithë fëmijët e vrarë dhe/ apo të zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë.

10

11

Në kuadër të këtij projekti, organizohen ligjërata dhe punëtori një ditore në shkolla të mesme dhe universitete të Kosovës, duke ua prezantuar nxënësve/studentëve të dhënat e sakta mbi humbjet njerëzore si pasojë e luftës në Kosovë. Gjithashtu, ata informohen mbi rëndësinë e zbatimit të mekanizmave të drejtësisë tranzicionale.

Së paku një herë në vit organizohet shkolla e Drejtësisë Tranzicionale që zgjat për 5 ditë, ku pjesëmarrësit kanë mundësi të dëgjojnë nga ekspertët e fushës mbi temat e Drejtësisë Tranzicionale si dhe të vizitojnë vendet e krimit dhe të bisedojnë me familjarët e viktimave.

Angazhimi i FDHK vazhdon të mbetet në fushën e Drejtësisë Tranzicionale duke zbatuar projektet e lartpërmendura.

Qendra e Dokumentimit Kosovë është themeluar në vitin 2017, si një hapësirë publike që shërben për informim rreth luftës në Kosovë, drejtësisë tranzicionale dhe ballafaqimit me të kaluarën. Të dhënat e mbledhura me vite nga gjykatat, publikimet dhe hulumtimet prezantohen në forma të ekspozitave, dokumentarëve, ligjëratave dhe debateve në mënyrë që publiku të informohet mbi faktet e luftës në Kosovë dhe të krijohet një hapësirë e re gjithëpërfshirëse për krijimin e kujtesës kolektive.

Në QDK zë vend ekspozita e përhershme mediale 'TPNJ: Rasti i Kosovës 1998 - 1999' e që përfshin 9 dokumentarë, të cilët prezantojnë narrativat se si janë hetuar, rekonstruktuar dhe ndjekur krimet në Kosovë nga TPNJ.

Që nga hapja e kësaj hapësire e deri tani, aty janë organizuar disa ekspozita dhe janë mbajtur shumë ngjarje publike. Fillimisht është hapur ekspozita me fotografi nga fotografi i luftës, Wade Goddard gjithashtu edhe ekspozita e skulptorit Ismet Jonuzit

'Struktura e Pages'.

Në QDK, që nga 13 maji i vitit 2019, është hapur ekspozita 'Na ishte një herë që kurrë mos goftë', ekspozitë kjo e cila është bazuar në punën shumëvjeçare të Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë. Ideja për këtë ekspozitë ka ardhur si nevojë për t'i kujtuar fëmijët që kanë humbur jetën dhe/apo janë zhdukur gjatë viteve 1998 - 2000 në Kosovë.

Me vullnetin që fëmijët të njihen dhe të kujtohen, FDHK ka genë i bindur se kjo ekspozitë duhet të përmbaj emra, fotografi dhe gjësende të tyre. Meqë ekspozita i kushtohet jetëve të fëmijëve, është synuar që rrëfimi i tyre të ketë edhe copëza jete e jo vetëm informata rreth vdekjes së tyre.

Emrat dhe fotografitë janë si rezultat i të dhënave të mbledhura në projektin 'Libër Kujtimi i Kosovës'. Ndërsa, gjësendet janë mbledhur përmes një bashkëpunimi të ngushtë me familjarët e viktimave.

FDHK ka kontaktuar një numër shumë të madh të familjeve për të pasur një përfshirje sa më të madhe gjeografike dhe etnike. Në këto komunikime kemi kuptuar që, pasi një numër i madh i shtëpive janë djegur, shumë prej familjarëve nuk kanë arritur të ruajnë asnjë gjësend të vetëm të fëmijëve të tyre, ndonjëherë as edhe një fotografi.

Ekspozita 'Na ishte një herë që kurrë mos goftë' është dedikim për të gjithë fëmijët e vrarë dhe/apo të zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë.

Blerita Hoçia  
Kuratore

NA ISHTE NJË  
HERË QË KURRË  
MOS QOFTË

12

13

02

# Në kujtim të 1133 fëmijëve të vrarë si pasojë e luftës në Kosovë 1998–2000

1024 fëmijë të vrarë  
109 fëmijë të zhdukur

14

15

Na ishte njëherë është fillimi i natyrshëm i çdo përralle. Në këtë rast, është fillimi i rrëfimit të luftës. Nën shikimin naiv të fëmijëve na çelet një botë që nuk duhet t'i përkasë reales, ashtu si përralla.

Një dhomë xhami brenda hapësirës përmban të gjithë peshën e objekteve.

Për të na kujtuar që kjo ekspozitë të shihet nga këndvështrimi i fëmijëve, këto objekte qëndrojnë pezull si në përrallë, si të përgjumura brenda kutisë së xhamtë. Një përgjumje në dukje e këtyre objekteve të lëna në errësirën e pandërgjegjies që e zgjon kujtesën personale dhe kolektive nga nevoja për të harruar vazhdimisht. Këto objekte dhe veshje këtu brenda rreshtin së genit objekte dhe veshje. Ato shndërrohen në rrëfime personale që përcjellin praninë e vetë fëmijëve. Një prani kjo e një dimensionit tjetër, përzier me plumba dhe përralla e që kriset befshëm ashtu si xhami që i përmban duke bartur mbi vete të gjithë simbolikën e tij.

Kjo ekspozitë vjen si një ftesë për përballje dhe për reflektim, për dialog dhe shërim, duke nisur ndërtimin e një kujtese kolektive me anë të këtyre sendeve dhe të tjerave që do të shtohen në të ardhmen.

Objektet, që iu përkisnin fëmijëve, na kujtojnë përditshmërinë, jetën monotone, gjërat e vogla të çmuara që nuk i vëmë re gjithmonë. Disa prej tyre na rrëfejnë për një lojë që e heshtur vazhdon akoma.

Ndoshta një lojë që e shoqëroi bashkëjetesën me luftën dhe vazhdon të reflektohet te të gjitha sendet e mbetura që përcjell shikimin e butë të fëmijëve i cili shëron dhe çliron rreze shprese duke e bërë kujtimin e tyre të përjetshëm.

Më shumë se sa një ekspozitë, ky është një memorial dedikuar fëmijëve të vrarë dhe të zhdukur në luftë. Pse bëhen memorialët dhe pse ruhen rrënojat e pasojave të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut?

Nuk janë vetëm për t'i kujtuar dhe nderuar viktimat dhe të mbijetuarit, por edhe për të kërkuar të vërtetën.

Në kërkimin e kësaj të vërtete është plotësisht i angazhuar edhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe për krijimin e këtij memoriali është folur me prindërit e familjarët e viktimave dhe kjo ekspozitë shpreh dëshirën e tyre për t'i kujtuar ata me gjësendet e vetme të mbetura të një fëmijërie të ndërprerë.







# Gramoz Berisha

Me 26 Mars të vitit '99, dikun rreth orës 12, kanë ardh forcat policore te shtëpiat tona, në Suharekë. Na jemi konë bashkë, fëmija, gratë edhe babi, axhallarët, gjithashtu janë konë edhe të axhës të babit, edhe kanë ardh, janë afru forcat policore te shtëpiat tona, kanë thanë, dilni jashtë, burrat, kanë thanë, le të nalen në oborr këtu, e ju, gratë edhe fëmitë, vazhdoni ecni shkoni për Shqipni.

Në momentin që kemi dal jashtë, burrat i kanë nal aty në ballkon të shtëpisë, neve na kanë thanë, dilni në rrugë edhe vazhdoni për Shqipni. Na kemi vazhdu me ecë, kur në ato momente i kemi ni edhe krismat e para, edhe kemi marr vesh që diçka e keqe ka me na ndodh, nuk kemi guxu me kthy kryt, as me kqyr çka po ndodh, veq kemi vazhdu me ikë, ka kemi mujt.

Shumica jemi nis në drejtime të ndryshme, unë jom konë me Altinin, djalin e Shyhretes, mami u nis dika tjetër, vllau, motra, secili në drejtime të ndryshme. Kur kemi mbrri te komuna, te rruga kryesore, jemi nal edhe jemi bo gjithë bashkë, e kemi pa që të gjitha rrugët janë të bllokume me policë, s'kemi guxu me vazhdu, edhe ja kanë nisë me gjujtë, atëherë e kemi pa që s'kemi ka me ja majt, përveç se me u kthy në qendër zejtare.

Kur jemi kthy në qendër zejtare, në qato momente, janë bashku edhe do kushëri tonë, kanë menu që neve po na qesin me kolonë edhe po pshtojmë, janë bashku edhe ata me neve, edhe gjithë bashkë kemi hy në lokalin picerinë, Kalabria, o konë i vetmi lokal qelë. Jemi fut gjithë mrena aty, shumica jemi kon gra edhe fëmi, rreth 40 anëtarë, në qat lokal jemi fut.

S'ka shku një kohë e gjatë, as 5 minuta, edhe kanë ardh forcat policore janë afru para lokalit, na të gjithë jemi shtri për toke edhe ata kanë fillu me gjujtje, pa ndërpre. Mamin e kom pas afër, më ka mbulu me trup të vetin përmi mu edhe më ka qit tesha, që i ka marr kur kemi dal prej shpisë. M'i ka qit përmi t'u u munu me më mbrojt prej plumave. Aty afër e kom pas edhe Shyhreten, Altinin, vllau e kom pas në tjetër qoshe të lokalit, edhe motrën qashtu, ka kemi mujt veq jemi shtri edhe tu u munu mu mbrojt prej plumave.

Gjujtjet kanë vazhdu qashtu, deri në momentin që nuk kanë ni mo asnji za, edhe s'kanë pa lëvizje. Në qato momente edhe më kanë plagos në krahë, por nuk e kom marr vesh, veç që jam pi, mu ka pi krejt trupi edhe e kom pa që kom fillu mu gjakos, po prapë s'kom guxu as kryt me çu, as me lëviz hiç, se jam tut po marrin vesh, edhe më gjujn'. Edhe kur e

kemi pa që po nisen me hi në lokal mrena me na kontrollu edhe një herë, atëherë Shyhretja i tha djalit të vet Altinit, tha, tash kur të vin me na kqyr ti banu si i vdekun edhe nuk na marrin vesh që jemi gjallë.

Edhe unë ashtu jom bo si i vdekun. Na kan kap secilin me ren, kur ka ardh radha te un', jam frigu në fillim mos po më kapin për krahun e plagosen edhe kisha reagu, për fat më kanë kap për krahun tjetër, më kanë qit në lese edhe më kanë gjujt në kamion.

Në kamion ka pas edhe trupa tjerë përmi mu, po prapë nuk kom guxu me lëviz, tu menu qe po më marrin vesh edhe kom menu që osht dikush në kamion tu na rujt. Mandej masi i kanë qit krejt trupat në kamion, kamioni u nis në drejtim të Prizrenit.

Gjatë rrugës mami ka fillu me fol me Shyhreten, po unë prapë s'kom guxu me lëviz, kom qëndru qashtu. Ato e kanë bo planin për me kcy prej kamionit, po mami ka thonë t'ia sho ftyrën edhe një herë, ma ka njoft jaknen, ka thonë, t'ia shoh djalit edhe një herë ftyrën, kur më ka kthy ka veti, më ka pa, unë i kom qel sytë, ka thonë, Mozi a je gjallë?, kom thanë po, ka thonë hajde me mamin kcejmë prej kamionit se këta na shtijnë me naj gropë edhe mandej sun dalim.

Në fillim, Shyhretja e la djalin Altinin aty, të myten, tha, unë po i lo f'mit këtu, bile nashti burrin e kam gjallë, ka kcy ajo, mandej mami më ka kap mu, po në qato momente, o kanë edhe një djalë tjetër gjallë, Mirati, nuk ka një vjet ma i madh se unë, edhe i kemi thonë edhe atij a po vjen edhe ti me neve, ai tha jo, tha, unë po du me shku me mamin, veq që, hekma qit grunë, ja kishin qit një trup përmi, hekma qit grunë se sun po marr frymë. Na kemi tentu me e marr, po ja nisi me bërtit edhe u frigum që po na marrin vesh, atëherë ja largum atë trupin, mami m'ka kap mu edhe kemi ra prej kamionit, kemi

kcy në midis të rrugës, se me kcy dika anash jemi tut mos po na shohin prej pasqyreve, edhe qashtu dytë t'plagosen jemi çu, kemi vazhdu me ec nëpër ara, aty afër në fshatin Malësi të Re, afër Prizrenit.

Gjatë ecjes nëpër livadhe, unë kom lyp ujë me pi edhe kemi pa një shtëpi përballë, mami tha po lypim ujë, ishin kon në oborr një burrë edhe një gru edhe u afrum, po kur u afrum afër, ai burri ish kon policë i veshen tu honger bukë, ajo gruja tha, qysh muj me ju ndihmu, mami tha a ka mundësi një gotë ujë për djalin, ka hi mrena, ma ka pru një gotë ujë, tha, ma gjatë na nuk mujna me ju majt këtu, po po ju kalojmë rrugën te një shtëpi e shqiptarëve.

Na kanë kalu rrugën, na kanë çu, kemi nejt pak në atë shtëpinë, po për shkak se u kanë shumë afër rrugës kryesore, s'kemi guxu ma shumë me nejt, se jemi tut' po vin me na kontrollu, edhe i kemi thonë, a ka mundësi me na çu me një fshat tjetër, fshatin Caparc, ku e kom pas tezën, ata na kanë marr na kanë çu, edhe aty kemi qëndru tre muaj deri sa u kry lufta.

Jemi mjeku kryesisht me barna popullore, barnat e vetme që kanë mujt me i nxjerr prej kishës katolike të Veleshës, përndryshe nuk ka pas barna tjera.

U kry lufta edhe gjithë kemi nejt me atë shpresën që ka mujt me pshtu edhe dikush tjetër si na, edhe pse i kemi pa në lokal, prapë s'kemi dashtë me besu atë që ka ndodhë. Mandej mas luftës nisën verifikimet, edhe nisën mu gjetë trupat, atëherë e pamë që prej asaj kohe, gjysa e tyne hala janë të pagjetun, gjysa e tjetër janë gjetë pjesë-pjesë. Nji pjesë u gjetë në Suharekë, një pjesë në Lubishtë, pjesa tjetër në Batajnicë në Serbi.

Në përfundim të rrugëtimit të nisur, dhoma e xhamit shfaqet e kthjellët dhe e mprehtë, e mbështjellë nën një dritë restauruese. Ajo i ngjan një dhome të kujtesës së pranuar, që nga ndrydhja në labirintet e mohimit dhe frikës, shndërrohet në një hapësirë të paqtë ku secili send e tregon historinë nga këndvështrimi i fëmijës që e pati kur ishte në jetë. Kjo hapësirë dhe objektet rreth saj mundohen të falin guxim për përballje. Një përballje kjo, shpesh herë e munguar në hulumtimin dhe pjesëmarrjen në kujtesën e dhimbjes.

# DHOMA E XHAMIT













Text panel on the central white pillar, containing several columns of small text.

GJËSENDET

34

35

E  
FËMIJËVE

# OBRI E EPËRME



26 SHTATOR 1998

# FAMILJA DELIU

Jeton Deliu [20.09.1988–26.09.1998]  
Menduhije Deliu [16.05.1994–26.09.1998]

39

Familja e gjerë Deliu jetonte në fshatin Obri e Epërme. Gjatë verës së vitit 1998, ata gjetën strehim në malin afër shtëpisë. Në datën 26 shtator të atij viti forcat serbe depërtuan në fshat dhe vranë 18 anëtarë të familjes Deliu, ndër ta edhe Jetonin dhe motrën e tij, Menduhijen. Babai i tyre ka mbërritur në vendin e krimit dhe aty e ka gjetur gjallë Diturijen akoma foshnjë në duart e nënës së saj, por më vonë në mungesë të ndihmës mjekësore edhe Diturija ka ndërrruar jetë.


Në këtë ngjarje tragjike mbetën të vrarë 18 anëtarë të familjes Deliu, ndër ta 8 ishin fëmijë<sup>1</sup>.

Tërfurku i përkiste Jetonit dhe, edhe pse shumë i vogël, ai kishte dëshirë të ndiqte prindërit në ara dhe të luante me tërfurkun e mamasë, prandaj babai i tij ia punoi një tërfurk pak më të vogël, që ai të mund ta mbante, me të cilin ai njëkohësisht luante, por edhe ndihmonte.

Saja i përkiste Menduhisë më të vogël në moshë, atë e kishte punuar babai dhe më herët e kishin përdorur vëllai i saj Jetoni dhe kushëriri i tyre Valmiri.



# PREKAZ I POSHTĚM



05 MARS 1998



# FAMILJA JASHARI

Avdullah Jashari [27.05.1982–05.03.1998]

Bujar Jashari [10.10.1987–05.03.1998]

Blerim Jashari [12.12.1992–05.03.1998]

45

Familja e gjerë Jashari jetonte në Prekazin e Poshtëm. Në mëngjesin e 5 marsit të vitit 1998, forcat serbe e nisën sulmin ndaj lagjes Jashari. Njëra nga shtëpitë e para që u sulmua, strehonte 11 anëtarë të familjes. Në njërin dhomë qëndronin gratë dhe fëmijët, përderisa burrat mbronin shtëpinë nga dhoma tjetër. Në mbrëmje të gjithë burrat u vranë, në mesin e tyre edhe Avdullahu, ndërsa në dhomën tjetër të vranë mbetën edhe dy vëllezërit e tij, Bujari dhe Blerimi së bashku me nënën e tyre.

Në këtë ngjarje tragjike mbetën të vranë 11 persona, nga të cilët 4 ishin fëmijë<sup>2</sup>.


Atë ditë, Avdullahu kishte të veshur këtë bluzë, me të cilën edhe e varrosën. Katër vite më vonë, para se t'a rivarrosin, familja e mbajti bluzën e tij si kujtim.

Pantallonat e shkurta të Bujarit e të Blerimit janë gjërat e vetme që kanë shpëtuar pasi shtëpia e tyre ishte djegur me gjithçka që kishte brenda dhe rastësisht këto pantallona i kishin lënë në shtëpinë e motrës së tyre, e cila jetonte në një fshat afër.





# STUDENICĚ



13 PRILL 1999

# FAMILJA LIPAJ

Qëndresa Lipaj [20.02.1984–13.04.1999]



51

Familja Lipaj jetonte në Studenicë. Me fillimin e bombardimeve, ata janë strehuar në shtëpinë e gjyshit që jetonte aty afër. Në datën 12 prill të vitit 1999, për shkakë sigurie, ata janë larguar nga shtëpia e gjyshit dhe kanë shkuar në fshatin Kaligan. Të nesërmen në mëngjes, Qëndresa me motrën, me gjyshen nga mamaja dhe me disa kushërira janë kthyer në shtëpinë e gjyshit, për të gatuar bukë dhe për të marrë veshmbathje. Ato më nuk janë kthyer në fshatin Kaligan dhe anëtarët e tjerë të familjes janë detyruar të largohen në Mal të Zi pa e ditur fatin e tyre.


Pas luftës në bunarin e asaj shtëpie u gjetën 9 persona të vrarë nga forcat serbe, ndër ta 4 fëmijë, Qëndresa dhe motra e saj Mirdona si dhe kushërirat e tyre, Lindihanë dhe Njomzë Lipaj.

Familjes i ka mbetur për kujtim çanta e Qëndresës që e kishte bërë gati për ta marrë me vete në mal, ku në mesin e gjëseneve të tjera kishte edhe dy sapunë dhe tableta për dhimbje koke.



PEJË

12 QERSHOR 1999



# FAMILJA BALA

Hajri Bala [06.08.1986–12.06.1999]  
Dardane Bala [14.09.1988–12.06.1999]  
Agon Bala [25.01.1993–12.06.1999]

57

Familja Bala jetonte në Pejë. Në datën 12 qershor të vitit 1999 në shtëpinë e tyre kishte ardhur për vizitë xhaxhai me gruan dhe tre fëmijët. Përderisa po përgatiteshin për të fjetur, forcat serbe kishin hyrë në shtëpi.

Pasi ua marrin paratë dhe arin, i mbledhin në një dhomë dhe shtien mbi ta, duke lënë të vranë aty: Hajriun, Dardanen, Agonin, si dhe dy vajzat e axhës, Rinën dhe Nitën, me nënën e tyre.

Këto bluza ata i kishin të veshura natën kur u vranë.




26



Small text block, likely a museum label or informational text, located in the upper right corner of the display case.

# PODUJJEVĚ



28 MARS 1999

# FAMILJA DURIQI

Arbër Duriqi [01.10.1991-28.03.1999]

63

Familja Duriqi ishin detyruar ta lëshojnë shtëpinë e tyre në fshatin Obranqë për t'u strehuar në Podujevë te familja Bogujevci.


Në datën 28 mars të vitit 1999, ata nxirren dhunshëm nga shtëpia dhe dërgohen në oborrin e një shtëpie aty afër. Forcat serbe hapin zjarr mbi ta, duke i lënë të vdekur 14 persona.

Aty janë vrarë Arbëri me nënën, vëllanë Albionin dhe me dy motrat e tij, Mimosën e Dafinën, dhe bashkë me ta janë vrarë edhe 3 fëmijë të familjes Bogujevci, Nora, Shpendi dhe Shpëtim Bogujevci.

Atë ditë, Arbëri këta klikera i kishte në xhepin e pantallonave, ato ia kishte blerë babai i tij, i cili, disa muaj më pas, i gjeti ata të shpërndarë në oborrin e asaj shtëpie.





An abstract drawing on the left side of the page, featuring a dense, chaotic network of overlapping lines in red, yellow, and black. The lines are thin and vary in length and direction, creating a complex, web-like structure. Some lines are straight, while others are curved or looped. There are also several small, scattered dots in red and black, some of which appear to be part of the line network. The overall effect is one of organic, almost cellular complexity.

# POKLEK I VJETËR

66

67

# 17 PRILL 1999

# FAMILJA MUQOLLI



Shehide Muqolli [03.02.1985–17.04.1999]  
Naser Muqolli [10.12.1986–17.04.1999]  
Ylber Muqolli [07.09.1989–17.04.1999]  
Egzon Muqolli [18.05.1995–17.04.1999]

69

Familja e gjerë Muqolli janë detyruar t'i lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të nisen në drejtim të Gllgovcit në datën 17 prill të vitit 1999. Pasi nuk janë lejuar të vazhdojnë rrugën, ata janë kthyer në shtëpi.

Ajo ditë ishte e ftohtë e me shi prandaj shumë të afërm të familjes Muqolli, rreth 60 persona, u bashkuan në një shtëpi, edhe për t'i veshur e ushqyer fëmijët. Gjatë asaj dite, shtëpia është sulmuar nga forcat serbe duke lënë të vdekur 53 persona, nga të cilët 24 ishin fëmijë<sup>3</sup>. Shehidja, Naseri, Ylberi dhe Egzoni, së bashku me nënën e tyre dhe familjarë të tjerë mbetën të vdekur aty.

Librat dhe fletoret e Shehides, Naserit, Ylberit dhe Egzonit u gjetën nga babai i tyre, të shpërndara nëpër oborr.

Sot, ato mbesin ashtu siç ishin, të mbuluara me baltë nga ajo ditë me shi.

Murat Misha

# ATLAS GJEOGRAF

për shkollë fillore




Prishtinë, 1998



Seniha Spahiu • Zeqirja Ballata

## EDUKATA MUZIKORE


PËR KLASËN VII-VIII TË SHKOLLËS FILLORE



KLARINET E DOLTORE

Shpirtorja metalike

- a - kamf
- b - telepodon
- c - krahë mipekthja
- d - vatra lumbjatzë



Perforuesi  
Katerizat

Pllakë  
mbrajtes

hendesi metalike 6-160  
Krahja e lumbjatzë 80-140


Musica metalike



Perforuesi

Katerizat

- a - kamf
- b - telepodon
- c - krahë mipekthja
- d - vatra lumbjatzë



VIZATOSE

Handwritten notes at the bottom of the page.

Kroi i fshatit tone

Kroi i fshatit tone  
 Kroi i fshatit tone  
 Kroi i fshatit tone  
 Kroi i fshatit tone  
 Kroi i fshatit tone

U Viteve Mijë K. L. Vite

DI ESAT DAUTI  
GIRRRUS EMI

SHKODRA

Naser Murgulli Kol

Shkolla Fillore  
 Pazi Grejterci  
 Per Shqipëri

Shkolla e Indon velet lart dakt  
 të shqipërisë të shqipërisë

Të shqipërisë të shqipërisë

Shkolla e Indon velet lart dakt  
 të shqipërisë të shqipërisë

**ZËRA TË NATYRËS**

Shoket dhe shoqet e klasës vendosen të bëjnë një lojë ku të merrnin pjesë të gjithë. Po çfarë lojë sportive, popullore apo mësimore? Secili propozon një lojë lojë. Vetëm Naimi nuk foli. Ai degëz mendueshem. Meqë nuk po bërën dakord, ai e tjuan atij:

- Po ti çfarë propozon?  
 Naimi ngrii duart lart. Në të mbante aq sa nxënës kishte klasa.  
 - Këtu, - tha ai, - janë tridhjetë kartona me gjet me ilustrime kafshësh, çpendesh, sendesh. Secili nga ju brenda sësë minutave të shkruajë një bri ilustrimit çze lojë me kafsha, shpendi ose këshu ai do të përbijë sa di.  
 Të gjithëve i pëlqeu. Naimi shpërndau kartonat. Pas pesë minutash i mblodhi. Ja përgjigjet tyre:

Bubili ligës n  
 Bleta zë gumëzhin.  
 Delja b. zin  
 Gomar pellet.  
 Gjerp  
 Kalë aingëllin.  
 Macja mjaullin.  
 Gjeli  
 Miza zhuzhet.  
 Lopa  
 Muthkonja zhuzhet.  
 Pula kakara.

Era fshatit.  
 Deti buçet, uturin  
 Burimi gurgullon  
 Bubullama oshetin  
 Autoambulanca -  
 Mali jehon, oshetin  
 Ora tingëllon.  
 Dera kërcet.  
 Puhka kërcet.  
 Pylti oshetin  
 Treni  
 Topi gjemon.

Të kuptojmë fjalët


biem dakord - jemi të një mendimi

Të ushtrohemi në punë të pavarur

• Plotësoni shtyllat me + ose -, sipas modelit me poshtë:

	Zogu	Burimi	Ujku	Njeriu	Treni	Lopa
Flet	-	-	-	+	-	-
Blegeron	-	-	-	-	-	-
Mjaullin	-	-	-	-	-	-
Bucet	-	-	-	-	-	-
Pellet	-	-	-	-	-	-
Jehon	-	-	-	-	-	-

KORISHĚ



13 MAJ 1999



# FAMILJA AHMETAJ DHE FAMILJA KUKAJ

Arbnore Ahmetaj [18.08.1983–13.05.1999]

Saranda Ahmetaj [01.11.1985–13.05.1999]

Alban Kukaaj [17.10.1985–13.05.1999]

77

Shumë familje të fshatit Korishë u detyruan të lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të nisen për në Shqipëri, ndër ta ishte edhe familja Ahmetaj dhe familja Kukaaj. Në datën 13 maj të vitit 1999, forcat serbe ndaluan qindra qytetarë dhe i detyruan të qëndrojnë në një objekt të Armatës Jugosllave që ndodhej në një fushë të hapur në dalje të fshatit Korishë. Gjatë natës objekti ushtarak u bombardua nga forcat ajrore të NATO-s.

Në rimorkion e traktorit, të shtrira mbetën Arbnore dhe Saranda Ahmetaj pranë babait të tyre. Ndërsa, në anën tjetër, nga shpërthimi i fuqishëm gjeti vdekjen edhe Alban Kukaaj.

Në këtë ngjarje tragjike humbën jetën 76 persona, nga të cilët 32 ishin fëmijë<sup>4</sup>.

Nëna e vajzave ruajti për kujtim qezin që Arbnorja e përgatiti për vete si dhe fundin që e vishte Saranda kur kishte qenë e vogël.

Ndërkaq, familjarët e Albanit kishin arritur të ruajnë disa prej vizatimeve të tij. Në vizatimet, që shfaqin përditshmërinë e tij, Albani e ka vizatuar edhe autobusin me të cilin dëshironte të vizitonte babanë që jetonte në Slloveni.







ZHILIVODĚ



23 SHTATOR 1998



# FAMILJA KLINAKU

Ardiana Klinaku [27.03.1998–23.09.1998]

85

Familja Klinaku në mëngjesin e 22 shtatorit të vitit 1998 e kishte braktisur fshatin Bivolak dhe, bashkë me vendasit e tjerë, shkuan në mal të Zhilivodës.

Të nesërmen, forcat serbe kishin filluar granatimin e asaj zone. Ciflat e granatës e qëlluan Ardianën dhe, nga plagët e marra, ajo ndërroi jetë. Në këtë ngjarje tragjike humbi jetën edhe kushërira e saj, Fikrije Klinaku.

Fustani i përkiste Ardianës së vogël dhe ishte dhuratë nga halla.



# MANASTIRC



88

89

30 MAJ 1999

# FAMILJA HAXHIDEMA

Gazmend Haxhidema [23.12.1985–30.05.1999]

91

Familja Haxhidema jetonte në fshatin Manastirc. Në datën 30 maj të vitit 1999, babai, së bashku me djalin e tij Gazmendin dhe një tjetër familjar, janë nisur për të shkuar te një kushëri.

Rrugës, pranë shkollës së fshatit, forcat serbe kanë hapur zjarr mbi ta, ku kanë vrarë në vend babë e bir.

Kjo figurinë nga druri dhe lodra, tregojnë pasionin e Gazmendit për punë dore.

Ai e kishte gjetur këtë copë druri dhe e kishte shndërruar në suvenir, ndërsa lodrën e kishte modifikuar duke i shtuar një pjesëz elektronike.





RAHOVEC



09 MAJ 1999





# FAMILJA QMEGA DHE FAMILJA SHARKU

Visar Qmega [29.07.1986–09.05.1999]  
Azra Qmega [10.06.1988–09.05.1999]  
Venhar Qmega [12.05.1992–09.05.1999]  
Egzona Sharku [31.12.1991–09.05.1999]

97

Visari, Azra dhe Venhari me familje jetonin në Rahovec.

Me 8 maj të vitit 1999, ata bashkë me nënën e tyre, ishin në vizitë, pak shtëpi më poshtë, te gjyshi dhe gjyshja, ku jetonte edhe vajza e dajës, Egzona.


Rreth mesnatës, fqinjët kishin vënë re që dritat e të gjitha dhomave ishin të ndezura, gjë që ishte e pazakontë. Të nesërmen në mëngjes, tezja e tyre me djalin e saj të vogël, kanë hyrë në shtëpi dhe kanë gjetur në katin e parë të vrarë në shtrat, Visarin, Azrën, Venharin dhe Egzonën. Në katin e dytë të shtëpisë, e vrarë është gjetur edhe nëna e tyre si dhe gjyshi e gjyshja.

Bluzat e Visarit, Azrës dhe Venharit si dhe pizhamat dhe kapuçi i Egzonës janë gjërat e vetme që familjarët kanë arritur të ruajnë.






LLUZZHAN



102

103



01 MAJ 1999

# FAMILJA PETROVIQ

Nikola Petrović [07.05.1982–01.05.1999]

Marija Petrović [07.06.1984–01.05.1999]

105

Familja Petroviq jetonte në Graçanicë.


Në datën 1 maj të vitit 1999, gjyshja së bashku me mbesën Marijen dhe nipin Nikollën, ishin duke u kthyer në shtëpi pas një udhëtimi të shkurtër tek të afërmit e tyre në Prokuplje. Nikolla kishte ditëlindjen ato ditë e dëshironte ta festonte me miqtë e tij. Ndërsa ktheheshin, te ura në Lluzhan, autobusi ku ata udhëtonin goditet me projekttil nga forcat e NATO-s, duke i lënë të vdekur që të tre. Ata janë varrosur në datën 7 maj të vitit 1999, datë e cila përkonte me ditëlindjen e 17-të të Nikollës.

Në këtë ngjarje tragjike humbën jetën 38 persona, ndër ta 11 fëmijë<sup>5</sup>.

Jeleku i përkiste Nikollës, i cili ishte anëtar i shoqërisë kulturore–artistike ‘Simonida’ dhe e vishte atë sa herë performonte, ndërsa fundi ishte një dhuratë e gjyshes për Marijën kur ishte e vogël, të cilin nëna e saj e mbajti si kujtim edhe kur u rrit ajo e nuk i bënte më.



GJAKOVĚ



02 PRILL 1999



# FAMILJA DEMJAHA

Argjend Demjaha [04.07.1993–02.04.1999]

111

Familja Demjaha jetonte në Gjakovë.

Në datën 28 mars të vitit 1999, ata kanë shkuar në shtëpinë e gjyshërve, ku gjendeshin daja dhe familjarë të tjerë, sepse atje ndiheshin më të sigurt.

Në datën 2 prill të vitit 1999, në mesnatë, forcat serbe kanë hyrë në shtëpi dhe, derisa të tjerët kanë arritur të largoheshin, Argjendi është vrarë në gjumë. Të vrarë kanë mbetur edhe nëna e tij, gjyshi dhe gjyshja.

Pantallonat i përkisnin Argjendit dhe janë ndër gjërat e pakta që motra e tij ka arritur të ruajë.





Informational text card located in the upper right corner of the display case, containing several lines of small, illegible text.

# SUHAREKĚ



26 MARS 1999



# FAMILJA BERISHA

Altin Berisha [06.01.1989–26.03.1999]  
Redon Berisha [23.05.1997–26.03.1999]  
Kushtrim Berisha [20.05.1987–26.03.1999]

117

Anëtarët e familjes së gjerë Berisha u dëbuan nga shtëpitë e tyre në Suharekë ditën e 26 marsit të vitit 1999 dhe u ndalën pranë picerisë Kalabria në qendër të qytetit. Forcat serbe i detyruan të gjithë të futeshin brenda në lokal.

Lokali u sulmua disa herë duke vrarë 45 anëtarë të familjes. Gjatë sulmeve të forcave serbe, ata vranë Kushtrimin dhe Redonin. Altini ishte i plagosur rëndë, atëherë nëna e tij i tha: “Bonu moj nanë si i vdekun” dhe ai qëndroi ashtu pa lëvizur, por teksa po i bartnin trupat, ata vunë re se fëmija ishte ende gjallë, dhe e vranë në vend. Trupi i tij nuk është gjetur ende.

Në këtë ngjarje tragjike mbetën të vdekur 45 persona nga të cilët, 19 ishin fëmijë<sup>6</sup>.


Altini ishte nxënës i klasës së katërt dhe çanta e tij mban librat dhe fletoret sipas orarit të ditës së fundit që ai e përdori.

Këpucët i përkisnin Redonit i cili ende nuk kishte mbushur dy vjet kur e humbi jetën, ndërsa biçikleta kishte qenë një dhuratë nga prindërit për Kushtrimin, të cilën më pas e kishte ruajtur vëllai i tij.





# DOMANEK



04 MAJ 1999

# FAMILJA KRASNIQI

Donjeta Krasniqi [10.10.1992–04.05.1999]

125

Anëtarët e familjes Krasniqi ishin detyruar të braktisin shtëpinë e tyre në fund të muajit shkurt të vitit 1999 dhe të strehohen në malet e fshatit Domanek.

Rreth gjashtë javë kishin qëndruar aty bashkë me shumë familje të tjera. Në datën 4 maj të vitit 1999, forcat serbe granatuan malin dhe, si pasojë, aty e humbi jetën edhe Donjeta.

Në këtë ngjarje tragjike e humbën jetën 7 persona, prej të cilëve 5 ishin fëmijë<sup>7</sup>.


Donjeta i kishte me vete në mal brushën e dhëmbëve dhe kapësen e flokëve.







RAKOVINĚ



24 JANAR 1999



# FAMILJA KELMENDI

Besim Kelmendi [04.06.1986–24.01.1999]

Haxhi Kelmendi [05.03.1988–24.01.1999]

131

Familja Kelmendi jetonte në fshatin Rakovinë të Gjakovës. Nga fundi i muajit prill të vitit 1998 ata u detyruan të lëshojnë shtëpinë dhe kaluan një periudhë të gjatë duke u strehuar në fshatra të ndryshëm.

Mëngjesin e datës 24 janar të vitit 1999, babai, së bashku me dy djemtë e tij, Besimin dhe Haxhiun, shkuan të merrnin ushqim për kafshët, rrugës iu bashkuan edhe dy fqinjë. Kur po ktheheshin, afër urës së fshatit Rakovinë, mbi ta u hap zjarr nga forcat serbe dhe të gjithë mbetën të vrarë në rimorkion e traktorit.

Kur lindi Besimin, nëna e kishte blerë këtë batanije me të cilën më pas ishin mbuluar edhe fëmijët e tjerë. Batanija është ndër gjërat e pakta që nëna e tyre mori me vete kur ata u detyruan të braktisin shtëpinë.



NAGAVC



02 PRILL 1999



# FAMILJA BERISHA

Adelina Berisha [30.10.1990-02.04.1999]  
Njomëza Berisha [05.01.1993-02.04.1999]  
Shkurtesa Berisha [30.03.1995-02.04.1999]  
Lezie Berisha [17.07.1997-02.04.1999]  
Elhame Berisha [02.10.1998-02.04.1999]  
Shqipron Berisha [09.09.1987-02.04.1999]  
Dafina Berisha [05.06.1990-02.04.1999]  
Valmira Berisha [18.12.1991-02.04.1999]  
Valon Berisha [31.12.1986-02.04.1999]

137

Familja e gjerë Berisha nga Hoça e Vogël ishin detyruar të nisen për në Shqipëri. Rrugës ata u ndaluan në fshatin Nagavc dhe u detyruan të futen në oborrin e shkollës. Kur ra terri, e gjithë familja u strehua në bodrumin e një shtëpie të zbrazët aty afër.

Në datën 2 prill të vitit 1999, fshati Nagavc u bombardua nga forcat e NATO-s. Nga shpërthimi i fuqishëm, një pjesë e shtëpisë u shemb, duke lënë të vdekur 5 motrat, Adelinën, Njomëzen, Shkurtesën, Lezijen, Elhamen dhe kushërinjtë e tyre Dafinën, Valmirën, Shqipronin dhe Valonin.

Në këtë ngjarje tragjike humbën jetën 14 persona, prej tyre 12 ishin fëmijë<sup>8</sup>.

Djepi i përket vajzës së madhe të familjes Berisha, Adelinës, por aty janë përkundur edhe katër motrat e saj, Njomëza, Shkurtesa, Lezija dhe Elhamja.

Bluzat e Dafinës dhe Valmirës ua kishte sjellë babai i tyre nga Zvicra dhe vajzat i kishin veshur për festën e Bajramit, disa ditë para shpërthimit të 2 prillit. Këpucët e vëllait të tyre, Shqipronit, familja i kishte ruajtur ashtu siç i ka lënë ai, me tojat e njëërës këpucë të palidhura.

Familja ka arritur të ruajë bluzën e Valonit, që ishte dhuratë e babai të tij.









Fotografite që e përbëjnë këtë pjesë të ekspozitës nuk janë portretet e të gjithë fëmijëve të vrarë ose të zhdukur në luftë. Për këtë arsye, muri i portreteve shfaqet si një imazh përmbledhës i një fëmijërie të ndërprerë nga mizoritë e luftës, gati si një simbol që i përmban edhe ato portrete që mungojnë. Fotografite duket sikur qëndrojnë pezull duke ia besuar fuqinë e mediumit të tyre të tejdukshmërisë, me anë të së cilës projektohen në mur për ta shumëfishuar secilin imazh duke e përforcuar ndjesinë se ato në të vërtetë janë më të shumtë.




NA ISHTE NJË HERË  
QË KURRË MOS QOFTË

Në kujtim të 1133 fëmijëve të  
vrrarë si pasojë e luftës në  
Kosovë 1998–2000

1024 fëmijë të vrrarë  
109 fëmijë të zhdukur

Fondi për të Drejtën  
Humanitare Kosovë  
hlc-kosovo.org

Për të vizituar ekspozitën  
në mënyrë virtuale,  
ju lutemi skanoni kodin.



NA ISHTE NJË HERË  
QË KURRË MOS QOFTË

Në kujtim të 1133 fëmijëve të  
vrrarë si pasojë e luftës në  
Kosovë 1998–2000

1024 fëmijë të vrrarë  
109 fëmijë të zhdukur

Fondi për të Drejtën  
Humanitare Kosovë  
hlc-kosovo.org

Për të vizituar ekspozitën  
në mënyrë virtuale,  
ju lutemi skanoni kodin.



# MURI I PORTRETEVE



RRËEFIMET

152

153

03

Më 26 shtator të vitit 1998 në fshatin Obri të Epërme forcat serbe vranë 18 anëtarë të familjes Deliu. Si pasojë e kësaj ngjarje, Imer Deliu humbi 3 fëmijë, gruan dhe prindërit e tij. Imeri na i besoi dy nga sendet që i përkisnin fëmijëve të tij, sajën dhe tërfurkun. Ato qëndrojnë si pjesë e ekspozitës “Na ishte një herë që kurrë mos goftë”.

154

155

RRËFIMI  
I IMER

DELIUT

Me më pas thonë dikush për djalin, të rrnoftë sa rronon tërfurku, unë isha habit me të... është vetëm copë druri. E shpesh kam qajhtë kur e kam pa atë tërfurk në shtëpi.

Familja e gjerë Deliu i ka 8 fëmijë të vranë. Diturija, vajza ime e vogël, ka qenë e vetmja që i ka mbijetuar masakrës, por, si pasojë e saj, e ka humbur jetën pak kohë më vonë. Unë vet e kam nxjerrë nën trupin e nonës vet, ka qenë pa plagë, mirëpo ka jetu diku në mesin e kufomave rreth 24 orë. Përpos kësaj ka qenë një kohë që vazhdimisht binte shi edhe pse ka qenë 26 shtatori, ka qenë shumë ftohtë. Për një foshnje 6 javëshe ka qenë një situatë e papërballueshme, kështu që nga pasojat e kësaj, mas 5 jave jete, ajo ka vdekë. Pra, nga ajo ditë kur e kam marrë ajo ka pasur probleme me frymëmarrje, sigurisht një ftohje e thellë. E ka kontrollu doktorit dy-tri herë, por në rrethana të luftës s'ka pas ordinancë, thjesht ai është mundu me dhënë kontributin e vet aq sa ka mujt por, ajo deri aty e kish pas jetën. Gjithmonë kam dashtë me qenë i singertë se Diturija nuk ka qenë e vrave apo e masakrume por, ka vdekur më vonë.

Jetoni për 5 vjet ka qenë i vetmi fëmijë në familje. Ka qenë fëmijë i përkëdhelur dhe çdo gjë ka shku në favor të tij. Megjithatë prej mënyrës se si është rritur, kisha thënë se ka qenë shumë i

156

pjekun. Ndërkohë ka shku në shkollë deri në klasën e 4-të. Unë edhe sot kur e takoj mësuesin e tij, ai ende pa më fol, gjithmonë qan. Ka qenë nxënësi më i mirë në klasë, këtë po e them me fjalët e mësuesit. Por edhe në shtëpi e edhe në rrethin e lagjes gjithmonë ka qenë një djalë i hareshëm dhe i afërt me të gjithë.

Menduhija ka qenë 4 vjeçare. Unë gjithmonë i kam simpatizu flokët e gjatë e për fat ajo ka pas flokë të tilla, e kam dashtë tej mase. Po le që e kam dashtë po, ajo, kur kam ardhë prej pune, kurrë nuk më ka prit në shpi. Si 4 vjeçare, ka dalë gjithmonë e më ka prit te dera e oborrit.

Valmiri, djali i vëllaut, ka qenë lazdrani i familjes. Ai ka qenë shumë lozonjar, ka lujt shumë, ka qenë i pandalshëm në gjithçka. Ne jemi detyru kohë pas kohe nganjëherë me i bërtit nga pak. Por aq ka qenë inteligjent, saqë veç më ka kqyrë dhe kur më ka pa që kam buzëqeshë ka ardhë më ka përqafu dhe ka vazhdu ato lazdrimet e tij.

Këto sende në ekspozitë jo vetëm mu, por çdo familjar e kanë kthy mbrapa në kohë, e kanë kthy në ato momentet që ndoshta për atë kohë kanë qenë shumë të lumtura, po për sot janë shumë pikëlluese, se kujt i është kushtu, nuk është më. Saja më pak më kthen në kohë, ndërsa tërfurku ka qenë më interesant kur e kam maru. Sa herë e shoh më vjen ndër mend vendi në livadh ku kemi qenë tu punu, se përpara me tërfurk i kemi pas bërë punët. Edhe djali ishte dikun 3 vjet, jo më i madh, aq sa mundte me ec e ju kish rrok nonës vet me ja marr tërfurkun, -'nëma tërfurkun'-edhe qante dhe ajo ja dha që të mos qajë djali. Është dikun rreth 300 metra nga shtëpia ai livadhi ku punonim. Kur erdhëm në shtëpi, pasi hëngrëm mëngjes, më erdhi një ide, po unë mjeshtër po, të gjitha i maroj, pse e shti djalin me u rrok në sene të huaja. Dhe dola duke shëtit në mal dhe e gjeta një dru të mirë. Duhej me e përshtat për fëmijë të vogël, edhe e marova. Ai ishte i madh për të po, pas një viti veç e përvetësoi, ai e ka mbajt atë tërfurk edhe kur ska pas punë me të - 'është imi' - thoshte dhe e ka mbajt zvarrë. Me më pas thonë dikush për djalin, të rrnoftë sa rronon tërfurku, unë isha habit me të... është vetëm copë druri. E shpesh kam qajhtë kur e

157

kam pa atë tërfurk në shtëpi.

Kur keni ardhë në banesë për me diskutu mbi mundësinë e realizimit të një ekspozite me gjësendet e fëmijëve të vranë në luftë, isha shumë i gatshëm t'ju ndihmoja. Vetë ideja më është dukur e qëlluar. Kisha ardhë shpesh me e pa këtë ekspozitë, jo vetëm me pa gjësendet e fëmijëve të mi, por edhe të të tjerëve, sidomos klikerat. Më vjen mirë që ia keni kushtu punën kësaj kategorie. Gjithë kjo punë e mirë që është bërë, do të ishte dëm i madh sikur një ditë të thërrisni familjarët dhe t'iu thoni-hajde merrni gjësendet e juaja dhe t'i shpërndani. Do të ishte mirë që kjo ekspozitë, ato gjësende të fëmijëve të vranë në luftë, që nuk janë pak, me u përmbledh, me u kategorizu me diçka, me pas një përkujdesje të vazhdueshme për to, sikur një memorial që ngritet diku edhe në goftë se nuk e mirëmban, natyra vetvetiu e shkatërron, e humb. E njëjta gjë do të ishte me ekspozitën tuaj, me këtë punë të madhe që është bërë, sikur të ndaleni sot, ajo ngec. Mua nuk më takon me fol, por sikur institucionet të kujdesen për këtë punë do të ishte shumë më mirë.

‘Lufta e boni të vetën’—  
kështu e shpjegojnë dhimbjen që ua  
shkaktoi lufta e fundit në Kosovë  
prindërit Enver e Rrahime Lipaj.  
Gjatë një ofensive të forcave serbe  
në fshatin Studenicë, në datën 13  
prill të vitit 1999 ata humbën të  
dy vajzat, Qëndresën dhe Mirdonën.  
Sot, ata rrëfejnë për atë kohë, për  
të ardhmen që e kishin parë ndryshe  
për vajzat e tyre. Flasin edhe për  
çantën e Qëndresës, të cilën ajo e  
kishte përgatitur për ta marrë me  
vete në mal, por që në fund kishte  
mbetur në duart e nënës Rrahime.  
Pas 21 viteve, çanta është pjesë e  
eksponitës “Na ishte një herë që  
kurrë mos goftë”.

LIPAJ

158

159

RRËFIMI  
I RRAHIME  
DHE  
ENVER



Unë e di që vajzat e mia janë të varrosuna, për ata që janë ende të zhdukun familja e ka edhe ma vështirë, unë nuk mendoj veç për vete se ja u di ku i kanë varret, po mendoj edhe për të tjerët që nuk i kanë gjetë ende.

160

161

#### ENVER

Para luftës e kemi bo një jetë mesatare, por të lumtur me fëmijë. I kemi pasë 4 fëmijë. Dy vajza e dy djem. Duke ua pa rritën e të arritunat e tyne, por edhe fillimin e shkollës, kemi qenë të kënaqun me shogën. Të dy kemi qenë në arsim. I kemi rritë me kushte mesatare, por pa ankesa. Kur erdh lufta, lufta e boni të vetën. 13 prilli ishte ditë e kobshme për ne. Na i mori 2 çikat, nanën time dhe babën e shoqes. Përveç familjarëve të ngushtë, i mori edhe 5 të tjerë. Gjithsej 9 persona.

#### RRAHIMJA

Me datë 24 mars 1999 na u dashtë me dal nga shtëpia. Kjo na trishtoi shumë. Dy ditë ndejtëm në mal me familjarët e tjerë e me ne ishin edhe fëmijët. Atë ditë e kisha një parandjenjë shumë të çuditshme, por nuk e dija se çka është. Nuk mujsa me ecë. I merrsha hapat e tensionit ose merrja diçka tjetër. E çika e madhe, Qëndresa, po ma bënë 'nanë krejt gratë pak ma ndryshe, e ti po rrin si pemë', I thashë 'oj nanë nuk di, nuk kam shpirt, nuk muj me ec, nuk muj me dal, s'po muj, gjithçka po më duket si e randë'. Pas asaj u kthyem te shpia e babës tem. Ishim shumë anëtarë edhe të gjithë duhej me punu diçka, me bo bukë apo edhe me bajtë ujë. Çikat ishin ato që bajshin ujë e shpërndajshin ushqim. Edhe pse sado të vogla por prapë dukeshin si t'rrituna. Prapë gajo parandjenja s'më linte rehat. Ka qenë situatë e randë për mu, me do far andrra, me do ankthe. Kanë qenë shumë të padurueshme por, prapë thoja 'hajt se luftë është kjo,

ndoshta shpëtojmë'. Ato ankthet që i ndjen njeriu përpara, nuk duhet edhe me i lënë si në asgja, se me organizëm, me trup, e me krejt i ndjen që diçka po don me ndodhë. Por prapë thosha, hajt zot ishalla jo. Ishalla nuk ndodh kurgjo, ma e keqja mos të bohet. Dolem në mal prapë. Në mëngjes herët, dy çikat bashkë me babën tem Salihun, edhe me nanën e burrit dhe dy çika të tjera të kushërive janë kthy tek shtëpia për me bo bukë. Masnej Liridoni, djali i madh, me një djalë tjetër i kanë ra andej, i kanë thonë Qëndresës, hajdeni, ngutuni nisuni, ajo i ka thënë se gjyshja gati e ka bukën dhe si të pjeket ne vijmë rrugës e ju vini me na marrë. Në ato momente, diku para orës 10 të mëngjesit ka nis ofensiva. Erdhi Enveri edhe na gjeti në një far vendi. Më pyeti: 'A jeni të gjithë?'. I thash jo, 'ma mirë me vra veten' - tha, edhe aty menjëherë na filloi mundimi në organizëm. Deri sa kemi dalë dikun në bjeshkë, unë jom konë si e kputne. Si me ec në guj kanë thonë përpara, ashtu ka qenë ndjenja ime. E kur ato kanë dhanë shpirt unë jom liru, kom ec. Se e ndjeva një lehtësi shpirtërore. Se ai mundim ka qenë deri te vdekja e tyne, nuk ka qenë ma tutje. Enveri mbeti mbrapa, e na kemi shku në bjeshkë, kemi flejt përjashtë me fëmijë. Të nesërmen në mëngjes erdh Enveri edhe më tha 'merre djalin edhe kush jeni ktu e nisuni për Rozhajë'. Unë po rri dhe po kyçri nëpër bjeshkë edhe po pyes njerëz nëse i ka pa kush çikat. Kur shkum në Rozhajë erdhi një gru prej Vrelle. Atë e kish pas lanë burri i vet në rrugë. Ajo po na kallxon që i kanë vra do çika bashkë me Salihin e me.... - e

dikush e preku edhe i tha – ‘jo more Sali Blaka ish konë ai’ – edhe e la. E ai mendim më vjen gjithë para syve se qysh më tha ajo. Po mo nuk foli.

#### ENVERI

Datën e 13 prillit në anën e Studenicës, se gati krejt popullata ka qenë e përqendrome aty, menjëherë kanë nis me dalë në bjeshkë e me ikë për Rozhajë. Ofensiva e madhe e paramilitarëve dhe ushtarëve serbë ka ra herët edhe çka ka gjet përpara e ka bo shkrumb e hi, ka vra e ka pjek, e djegë, e tana i kanë bo. Unë jam kthy prapë, në shpi skam pas shancë me shku se në Kaligan kanë qenë të stacionum ushtria paramilitare e militare. Kam ardhë deri te një krua, i thonë ‘krua i Azës’, kam ardhë deri aty po s’kam pas gjasë me vazhdu. Me saktësi s’kam pa kurgjo, por doli flaka në shtëpinë tonë te rruga edhe e pamë që veç kanë hy forcat brenda. Studenicën e kanë përfshi edhe kë e kanë gjetë brenda e kanë vra. Por kur dilja në bjeshkë, kë e takoja, më thoshin ‘o i kemi pa edhe çikat edhe nanën tënde në bjeshkë përpjetë’, – tash kur e mendoj, e kanë pas veç sa me më largu e mos me ra edhe unë viktimë nga forcat serbe. Ata kanë shku në Rozhajë e unë kam mbet në bjeshkë, i kam lyp nëpër bjeshkë s’ka, lyp s’ka, edhe zemra më thoshte që ato i kanë pushkatu, i kanë vra, se aty s’mbeti njeri i gjallë më. Gruaja me dy djemtë shkuan për Shqipëri e unë kam mbet tu kqyr tu përcjell mos po takohem me dikë po nuk ka, nuk ka mo kurgjo hiç. Më ka thirr një djalë i axhës prej Ulqinit e po më thotë – ‘Enver, Rrahimen e ki shumë smut’ – thash don me më

gjet edhe kjo tjetra, se tash unë çikat spo muj me i gjetë e as nanën time dhe baben e shoges, ai tha – ‘tu kisha lut me shku në Shqipëri’. Unë e mora shumë seriozisht, e thashë njëmend është sëmurë prej mërziisë edhe i kom hyp autobusit në Rozhajë. Kur kam shku atje e kam pa Rrahimen që është mirë, e kuptova që ai ka dashtë veç me më largu prej rrezikut. Ndejta pak ditë aty dhe u ktheva prapë. Një djalë i axhës tha që kish qenë në Studenicë, te shpia e Salihut, bunari ishte i shembur krejt. A ka, a s’ka gjo brenda nuk dihet, e kjo ka qenë me 24 qershor. Unë kam arrit me 26 qershor edhe e kam qelë bunarin me do bashkëfshatar të mi të Studenicës edhe ushtar të UÇK–së që kanë qenë në Vrellë edhe e kanë thirrë edhe KFOR–in. Kur kam ardhë aty, ma ka thonë zemra e mendja se këtu duhen me qenë edhe jemi organizu me pak fshatar e tani kemi hy e i kemi nxjerrë, po ka qenë problem me hy aty. Tani, për me i humb gjurmët ata kanë marrë gëlqere dhe i kanë gjujt brenda edhe shporetin e gjithçka tjetër. Po prej gjithë asaj të keqe del edhe diçka e mirë. Për me hy i pari, thashë hy unë se mos ka naj eksploziv a najsen edhe e kemi marrë shporetin edhe e kemi hekë. Mandej jemi organizu me një qekerckë të bunarit edhe e kemi marr një konop edhe kemi hy.

Kur e kemi heq edhe gurin e fundit, nipi jonë tha – ‘dajë këtu janë’ – a din jam çliru. Ja kemi nis ngadalë me e nxjerrë njo nga njo dhe i kemi nxjerr të 9 trupat. Qashtu të ruajtun si kanë qenë para se me u vra. I kanë vra e i kanë gjujt menjëherë. Shyqyr qe s’iu ka ndodhë edhe najsen e me pa edhe naj krim me sy. Unë e di që vajzat e

162

mia janë të varrosuna, për ata që janë ende të zhdukun familja e ka edhe ma vështirë, unë nuk mendoj veç për vete se ja u di ku i kanë varret, po mendoj edhe për të tjerët që nuk i kanë gjetë ende.

#### RRAHIMJA

Kemi shumë momente me çikat kur kanë qenë më të vogla. Unë i kam pas dy prind e ata mbetën vetëm në pleqni. Ajo e madhja shkonte te nana, se gjimnazi ka qenë në Studenicë e në vitin e parë ka shku shpesh atje. Thojke baba jem – ‘more ku pe merr çika që po ma bjen këtë kafe në mengjes si po çohem’, e nana i thoshte që e ka njëfarë zjerri me plin, e po ta bjen kafën. Unë shkojsha shpesh edhe te prindërit dhe kur u kthejsha në shpi gjithçka e gjejsha gati, me bukë, me fshesë, të gjitha i gjeja të përgatitura. Çikat nuk e kanë çu mirë mes veti. Më vjen në mend se kudo që u konë Mirdona, Qëndresa nuk ka shku, se thojke: ‘mam nuk vi unë se kjo flet shumë, nuk muj me duru’. Qëndresa e ka pas mendjen veç te mësimi se unë e kam pas nxënëse e kam qenë kujdestare e saj. Najherë ajo habitej e me thirrte nanë edhe nxënësit pasta j krejt më thirrshin nanë. Më thoshte – ‘nanë përpara më mësoje diçka, më jepje këshilla, më jepje naj hartim, tash hiç’. Po i thosha, – ‘tash po të jap mësim, tash ti duhet krejt këto me i mësu vetë’. Në përgjithësi, çikat i kam dashtë ma shumë. Kanë thanë do djem se arsimtarja s’po na don. Unë në përgjithësi i kam dashtë çikat, se e kam ditë që gjithmonë ato hekin keq. Çikat kanë qenë gjithëherë të mira, se i kanë pas notat e mira.

Më kujtohet kur thojke një profesor i

Gjuhës Shqipe për Qëndresën. ‘Ku na ke çu këtë dukat, ari’ – thoshte për të. ‘Ajo çka flet, flet saktë, ajo nuk flet asnjëherë diçka gabim veç gjithmonë saktë’, – jo bre thoja se e kam mësu unë, e di sa din.

Qëndresa e ka bo gati çantën ma herët para se me dal, aty i ka marrë librat me mësu se librat i donte. Çanta ka qenë ajo që e kemi zgjedh edhe për këtë ekspozitë mbasi e ka përgatit me të gjitha sendet për me ikë. Çanta ka mbetë me mu, unë e kom pas gjithë me veti në bjeshkë e në Shqipni. Kur e pashë në ekspozitë, u ndjeva mirë se përveç qe e shoh unë çantën, e shohin edhe tjerët. Jam ndjerë mirë që po publikohet diçka dhe mos të mbeten në harresë këto sende.

#### ENVERI

Që nga hyrja në derë kryesore të ekspozitës, emrat kur i kam pa edhe rrëfimin e Gramozit kur e kam dëgju nuk di qysh me përshkrua. Kur e pashë çantën e Qëndresës, mu duk sikur po e shoh atë rreth xhamit. Të kish mbetë çanta tek na në shpi shumë ma keq mu kish duk, se unë kurrë s’kam mujt me e çelë. Sot vi këtu edhe shoh, edhe sendet e fëmijëve tjerë njejtë.

Më vjen keq për fëmijët e zhdukun se është shumë e randë. Unë për vete po them, është ma e lehtë se e di ku e kanë varrin, po është shumë e randë për ato familje që nuk e din se ku i kanë fëmijët e vet e të afërmit.

Familja Petroviq kishte jetuar një jetë të qetë deri në datën 1 maj të vitit 1999, kur dy fëmijët e tyre, Nikolla dhe Marija me gjyshen po ktheheshin me autobus nga Nishi. Atë ditë NATO e kishte qëlluar autobusin ku gjendeshin shumë udhëtarë, duke i lënë të vdekur edhe fëmijët bashkë me gjyshen e tyre. Pas 21 viteve, Dragisha dhe Zorica shpalosin kujtimet e së kaluarës dhe na tregojnë më shumë për fëmijët e tyre.

164

165

RRËFIMI  
I ZORICA  
DHE  
DRAGISHA

PETROVIQ

“Kur është dashur ta ketë ditëlindjen, Nikolla atë ditë, pikërisht në ditë të lindjes është varros. Atë ditë ai i kish mbush 17 vjet.”

166

167

#### DRAGISHA

Para luftës kemi jetuar mirë, po mendoj krejt familja bashkë, unë me Zoricën, prindërit dhe vëllai im më i riu, Gorani - ai ka vdekur në vitin 1997. Ka vdekur i ri, 32-33 vjeç, prej zemrës, në gjumë ka vdekur. Ne jemi 4 vëllezër, unë më i vjetri, mandej dy vëllezër të tjerë që nuk kanë jetuar me ne, ata janë martuar e kanë jetuar në Prokuplje. Më vonë kanë lindur fëmijët. Unë, në atë kohë, kam punuar në Energoinvest, kemi punuar bashkë me Zoricën.

Zorica ka filluar aty punën në vitin 1997, kurse unë edhe më herët. Fëmijët kanë shkuar në shkollë në Graçanicë. Djali im më vonë ka shkuar në shkollë të mesme në drejtim për PTT (Posta, telefoni dhe telegrafi) në Gërmi, aty ka qenë shkolla, ndërsa vajza ka qenë akoma në shkollë fillore. Djali ka shkuar edhe në folklor, ka dalë me fëmijë të tjerë të luaj. Çika ka pasë qejf të aktroj si fëmijë, në klasën e parë, dytë, edhe në të tretën ka pasë shfaqje në shkollë, e asaj i ka pëlqyer gjithmonë me marrë pjesë. I ka pëlqyer edhe recitimi, në krejt ato që i kanë organizuar në shkollë, ajo merrte pjesë, përgatitej. Ajo ka qenë edhe nxënëse shumë e mirë, ka mësuar shumë. Më e mirë se djali, edhe ai është përpjekur, ama asaj i ka pëlqyer mësimi, ka qenë nxënëse e shkëlqyeshme, kishte vet qejf.

#### ZORICA

Unë zakonisht kam shkuar në mbledhjet e prindërve, se Dragisha ka qenë në punë. Nikolla e ka pasë një kujdestare, ajo më ka thënë që Nikolla nuk është edhe shumë i

mirë në lëndën e gjuhës serbe, ama është aq i dëgjueshëm edhe i sjellshëm, shumë i urtë, nuk vrapon poshtë e lartë, nuk ikën prej dritares, nuk bën kaos e probleme, edhe nëse nuk i bën krejt detyrat unë prapë kam me ia dhënë një notë të mirë, veç pse është kështu i kuptueshëm edhe aspak problematik.

#### DRAGISHA

Nikolla kur e ka përfunduar shkollën fillore, vet ka pasë qejf me shku në atë shkollën për PTT, të telefonave. Me i vendosë telefonat fiks e me i lidhë. Këtu e kemi pasë një kojshi, që e ka bënë atë punë, e Nikolla shkonte te ai me marrë zanatin. Ajo gjë i ka pëlqyer dhe ka shku me i pa si punonin, për praktikë. Ndërsa Marija mendohej në cilën shkollë të mesme të shkonte, nuk është që ka mbërrirë taman me vendos, ama ka mendu të shkoj në shkollë të mjekësisë, se aty donin të shkonin edhe disa shoqe të saja. E ashtu thoshte - 'ndoshta në shkollë të mjekësisë'. Ajo atë kohë e kishte përfunduar klasën e tetë.

Nikollës i ka pëlqyer edhe futbollli e basketbollli. Këtu te rrethi afër e kemi pasë edhe një kosh të vendosur, krejt fëmijët luanin aty. I ka pëlqyer basketbollli, por ka pasë edhe shumë qejf me pa futboll në televizion. Ai ka qenë me Crvena Zvezdën e unë me Partizanin e nuk u pajtoheshim.

Edhe me folklor e vallëzim i ka ra me udhëtu. Plot ishin edhe më të vjetër, gajdexhi e disa gra që këndonin, krejt bashkë shkonin edhe me grupin e fëmijëve. Kanë shku në Vrnjačka Banja, në Kragujevc, i kanë thirr nëpër Serbi kudo.

ZORICA

Fëmijët s'kanë ditë as jo me thonë, i kanë dëgjju krejt, kush ju ka fol ata kanë dëgjju, nuk kanë bë sherre. Me 13 prill 1999, Nikolla i ka tregu një shokut të ngushtë që është duke u nisë për Serbi, - 'po më shtijnë me shku te axha atje, mu s'po më shkohet' - edhe atij i ka thënë 'as që dua të shkoj'. Nisen për të shkuar me makinë, por nuk iu ndezke, një 'Fiqë' e vjetër ka qenë. Hajt, ka mbetur nesër me u nisë prej Prishtinës me autobus. Autobusët në atë kohë nuk kanë kaluar nga Merdarja, po nga Vranja. Ata janë nisë bashkë me gjyshen. E mandej kanë dashtë të kthehen për shkak të ditëlindjes së Nikollës, që e ka pasë me 7 maj, e ka dashtë të kthehet 5-6 ditë më herët, s'iu ka prit. Edhe janë mërzitë, shtëpia e huaj, shoqërinë e kanë pasë këtu. Edhe pse atje në Nish janë shoqëruar me disa fëmijë, por prapë.

Njeriu nuk mundet kurrë me i harru ato momente. Kur isha duke gatu bukë, dëgjova që po vijnë dhe bleva mish për të përgatitë; radio ka qenë e lëshuar, një televizor i vogël krejt, pa ngjyra, veç bardh e zi. E lëshova radion, sa përgatisja drekën dhe dëgjova që NATO ka goditur diku. Ajo e dridhme e zhurmë edhe këtu është ndier. Rreth orës 12:00 kam dëgjuar në radio kur kanë thënë që është goditur autobusi që ka qenë duke ardhur prej Nishit në Prishtinë, në urën e Lluzhanit. Veç kam thënë 'oh kuku', vjehëri më pyeti çka u bë, unë i thashë çka dëgjova në radio, çka me mendu - bukën si e kam pasë në dorë më ka rënë. Kam dalë shpejt jashtë, shkova te gruaja e axhës e i thashë çfarë ka ndodhur. - 'Jo s'ka shansa, kush të tha, nuk e ke dëgjju mirë' -

'o mirë e kam dëgjju'...

Në anën tjetër, telefonat ishin ndërpre nuk ke pasë mundësi as me telefonu në Serbi. Edhe ashtu, jo po - jo jo. Është, nuk është. Në shtëpi vetëm britma e piskama. Unë nuk dija çka të bëj, Dragisha nuk ish këtu, vjehëri më thoshte ku po e di ti që ata kanë qenë në atë autobus. E dija unë se kunati i ka përcjellë, në mëngjes thirri tha janë nisë për Prishtinë.

Në autobus ka pasë civilë, serb e shqiptarë e krejt. Po puna që vjehëra ime e ka pasë një të afërme në Podujevë, e thoshin që janë ndal aty, e s'kanë qenë në autobus. Jo nuk e kanë goditë atë autobus, po një tjetër. Unë kam qenë e bindur që ka qenë ai autobus, se e kam ditë kur janë nisë ata, e kur kanë thënë autobusi që është dashur me mbërrri në Prishtinë në ora 12, krejt udhëtarët kanë mbetë në vend. Unë mendoja vet me vete a është e mundur që ka ndodh kjo, mandej veç britma e kukama në oborr e krejt janë mbledh kur kanë dëgjuar. Janë munduar krejt me marrë informata për me vërtetu a është e vërtetë, për me provu me kontaktu axhën e tyre me pa a janë nisë vërtet a jo. Dikur e kuptova që sigurt janë nisë, e dija që fëmijët në atë autobus kanë qenë, nuk kam pasë më çka me prit. Plot versione mandej dilnin... Unë kam qenë duke u çmend, dikur veç me hapa rrija, më kanë dhënë diçka për qetësim. Burri ish në punë dhe nuk e lajmëronin, unë veç vetë.

DRAGISHA

Kur më kanë thirr mua, unë veç kam dyshuar që diçka ka. Askush nuk ka dashtë të më tregojë ama krejt e kanë ditë, kur kemi hy këtu në rrugën tonë, krejt njerëzit

kanë qenë te shtëpia, kam thënë këtu diçka ka, kur erdha më thanë çfarë kish ndodhur. Mandej unë kam shku në Prishtinë me i pa trupat, e kam njohur Nikollën prej zinxhirit, e ka pasë edhe një kryq të drurit; Marija edhe ajo e ka pasë një zinxhir të arit e ashtu e kam njohur. Kurse nënën e kam njohur pak prej fytyrës, nga goja pak.

ZORICA

Mua nuk më kanë lënë të shkoj, ama prapë më ka mbetë një pamje e rëndë. Kurse këtiuj i ka mbetë edhe më keq, se ashtu i ka pa. I patën sjell të premtën, nja gjysmë ore ndoshta i kanë sjell në shtëpi, kanë qenë në arkivol të mbyllur dhe menjëherë i kanë dërguar te varrezat, shumë njerëz kanë ardhur.

DRAGISHA

Kur është dashur ta ketë ditëlindjen, Nikolla atë ditë, pikërisht në ditë të lindjes është varros. Atë ditë ai do i mbushte 17 vjet.

E dimë ne çka është ajo dhimbje. Mandej keni ardhur ju këtu, jeni interesuar. Ju kemi dhënë Jelekun, se atë jelek e ka vesh shumë Nikolla. Prej klasës së 6 është marrë me folklor dhe e ka pasë me vete kur ka shku nëpër udhëtime.

ZORICA

Ndërsa fundin Marijes ia ka ble vjehëra ime. Sa herë që ka shku në Pazar, ka pasë qejf me ia ble ndonjë fund, ky ka qenë më i miri. Nuk kemi shumë sende, i kam disa kur kanë qenë të vegjël krejt. Se atëherë ka qenë pak më ftohtë edhe kanë shku për me qëndru 15 ditë. I kanë marrë çantat me vete e i kanë

pasë edhe krejt sendet aty, ato që i kanë vesh më shumë. Për atë arsye ju kemi dhënë ato sende, se edhe nuk kemi pasë të tjera.

Fëmijët kanë kalu mirë me njëri-tjetrin, më thoshin - 'Babi ka shku në punë, na ndihmo t'i bëjmë detyrat' - e unë gjithmonë iu kam ndihmuar që ata t'i kryejnë ato. - 'Hajt nanë ti se e ke shkrimin e mirë...'.

Nganjëherë janë rrah e janë grind, kryesisht për rroba, se Marija ka pasë qejf me ia vesh rrobat Nikollës. Ai i blinte vetë në Pazar, çfare i pëlqenin, të gjelbërt, të kaltërt, xhempera me ngjyra-ngjyra. Ajo kishte qejf me u vesh gjerë, ia mernte Nikollës mandej, ndonjëherë ia mernte edhe babës së vet kur ishte në punë. E kur Nikolla kthehej në shtëpi e ia shihte, i bërtiste e i kërkonte t'i hiqte menjëherë se ishin të tijat. Po edhe kanë kalu mirë, kur ka shku njëri në shitore ka ble edhe për tjetrin, nuk është që kemi pasë shumë para, ne jemi mundu, por nuk kanë pasë edhe aq sa fëmijët e tjerë.

Eh tash çka të bëjmë, ka ndodhë. Ju ka ndodh shumë njerëzve, jo vetëm neve, po secilit për zemër të vet i djeg. Unë edhe sot sa herë të dëgjoj që ka ndodh diçka, ndonjë aksident, apo se ka vdekur ky a ai, menjëherë sytë më mbushen lot, edhe nëse asgjë s'e kam, por e di çfarë është ajo dhimbje. Krejt çfarë kam pasë më është marrë, e më vjen rëndë edhe sot kurdo që dëgjoj.

Isak Asllani me familjen e tij e bashkë me shumë fshatarë të tjerë, në mëngjesin e datës 26 gusht të vitit 1998, u larguan nga pylli i fshatit Grejgefc, ku po strehoheshin, për t'iu ikur të shtënave dhe bombardimeve nga forcat serbe.

Sot ai tregon se si kolona u zu në pritë afër Livadheve të Gjata dhe u hap zjarr mbi ta, me ç'rast humbën jetën 11 anëtarë të familjes, ndër ta edhe 7 fëmijët e tij. Isak Asllani është një nga shumë familjarë që i kemi kontaktuar për ekspozitë e që fatkeqësisht nuk iu ka mbetur asnjë gjësend. Shtëpia e tij ishte djegur po atë ditë, duke e lënë atë vetëm me kujtime të shpirtit.

170

171

RRËFIMI  
I ISAK

ASLLANIT

Është e fshtirë me përjetu këtë dhimbje, se kërkush nuk duhet me i varros fëmijtë e vet. Se tjetër është kur të vdesin prindërit, se me kalimin e kohës i sheh edhe bashkëmoshatarët e tyre tu u plakë e tu vdekë. Po me fëmitë është e kundërta, se kur vdesin ata, ti i sheh bashkëmoshatarët e tyre tu u rritë, tu shku në shkollë e tu jetu.

172

Na kemi jetu këtu në fshat, në Rancë. Nuk është që i kemi pasë pun't shumë mirë po nuk kemi hekë për diçka. Kur jom martu unë kena hongër krejt me një ven, me një pjatë, por kur mu bonën fëmijët, kom dashtë që secili me pasë pjatën e vet. I kom pasë 7 fëmijë, Burimin, Lumnijën, Ejupin, Luljetën, Shpendin, Xhaferin dhe Antigonën.

Dy prej fëmijëve, Burimi dhe Lumni ja kanë shku në shkollë në Carralevë. A dy tjetër, Ejupi e Luljeta kanë shku këtu në fshat, kanë mësu shumë, ju pëlqejke shkolla. Ejupi gjithë më ka befasu për të mirë, ai ka qenë shumë i gjindshëm, tu u rritë edhe zuni pak mu halitë, shumë fëmi i gjallë; a Luljeta ka qenë pak ma e urtë, ma e nalne, ndërsa Shpendi ka qenë ma agresiv, shumë i vështirë, veç me bo të vetën. Xhaferi e Antigona të vogël janë konë. Fëmijët shumë mirë e kanë çu mes veti.

Kur nisi lufta, nisën vrasjet, unë kam qenë i përgaditun që dikon kanë me ma vra, po bash krejt, jo. Edhe pse kanë kalu ma shumë se 20 vjet, për mu ajo ditë më duket si me pas ndodhë dje.

Me 26 gusht 1998 kemi dalë krejt banortë, me traktora jemi nisë mu largu. Unë jom konë tu i grah traktorit, njonin vlla e kom pasë përpara në traktor, mbrapa në rimorkio u konë nana, janë konë dy gratë tona, 7 fmitë e mi edhe çika e vllaut.

Kur kemi mbrri me një fushë, mes Grajgevcit edhe Topillës, te një vend që quhet Livadhi i Gjatë rreth orës 1 të mesditës, kemi ra në pritë të forcave serbe. Kanë gjujtë me lloj-lloj armësh, edhe e kanë rrokë traktorin tonë, na edhe jem konë të parët në kolonë. Qysh e kanë gjujtë, krejt i kanë vra, unë e vllau jemi plagosë. Pak më poshtë në kolonë u konë edhe vllau tjetër me një traktor, ai u plagosë keq. U konë një mjek që pat qëllu aty, na tha që duhet me çu në Prizren menjihërë ose nuk pshton. Kanë ardhë dy shokë të luftës e kanë marr, më kanë thonë 'Na e marrim e çojmë e qysh ja bojmë është puna jonë'. Sot vllau jem është gjallë e shnoh, e ka fëmijë.

E nanën, grunë me 7 fëmijët e mi si dhe grunë dhe çikën e vllaut i kemi varros në fushë, aty ku janë vra.

Shpijat tona në katun i kanë djeg atë ditë, me çka ka pasë në to, gjithçka u konë rrafsh me tokë. Edhe ato pak sene qe i kemi

marr me vete kanë metë qaty në fushë atë ditë.

E në vitin 2002, i kemi nxerrë trupat prej asaj varrezës së përbashkët, e i kemi pru këtu në tokë të babës, në Rancë edhe e kemi vendosë pllakën përkujtimore, afër e kemi pru edhe rimorkion e traktorit, në ata që janë vra. E tash vonë, edhe aty te vendi ku ka ndodh e kemi qit edhe një lapidar, shoqnia më ka ndihmu shumë, edhe komuna një pjesë e ka bo.

Jom ndi shumë i shlirum kur janë sheju këto vende, edhe këtu lapidari, po sidomos te vendi i ngjarjes, se është me rëndësi me u mbajt në mend.

Është e fshtirë me përjetu këtë dhimbje, se kërkush nuk duhet me i varros fëmijtë e vet. Se tjetër është kur të vdesin prindërit, se me kalimin e kohës i sheh edhe bashkëmoshatarët e tyre tu u plakë e tu vdekë. Po me fëmitë është e kundërta, se kur vdesin ata, ti i sheh bashkëmoshatarët e tyre tu u rritë, tu shku në shkollë e tu jetu.

173

Hazir Reka  
Fotograf

# FOTOGRAFIA

174

175

SI PJESË E HISTORISË



Gjithmonë brengë i kam pasur fëmijët, sepse ata kurrë nuk kanë marrë vendime për veten e vet, gjithmonë ka marrë dikush tjetër vendime për ta, për të mirë apo për të keq. Lufta ua ka shkatërruar fëmijërinë, kanë parë dhe kanë përjetuar tmerre që do t'i lënë me trauma tërë jetën e tyre.

176

177

Fotoreporterit kosovar, i njohur edhe në botë, Hazir Reka, e ka filluar punën si fotograf që nga viti 1983. Prej vitit 1984, ai i ka përcjell ngjarjet socio-politike dhe ka punuar për gazeta të ndryshme në Kosovë, ish-Jugosllavi e më gjerë. Fotografitë e tij kanë zënë vend në agjencitë, revistat e gazetave e njohura botërore si Reuters e New York Times.

Fotografimi i ngjarjeve historike, për Rekën, ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse ato e tregojnë rrëfimin e Kosovës, prej luftës e deri te pavarësia e saj. Ai i ka fotografuar grevat e minatorëve, demonstratat, protestat e studentëve, të grave, protestat paqësore, luftën, eksodin, refugjatët, kthimin, fillimin dhe normalizimin e jetesës. Me qëllimin e vetëm që historia e Kosovës të dokumentohet dhe që përmes tyre të tregohen copëza jete nga e kaluara e vështirë e fëmijëve, e grave dhe burrave.

Gjatë luftës Hazir Reka iu bashkua ekipit të Reuters-it në fotografimin e ngjarjeve të luftës ku në fokus të shumë fotografive të tij i gjejmë fëmijët.

Një fotografi e tillë është edhe në ekspozitën 'Na ishte një herë që kurrë mos goftë', fotografi e cila është shkrepur në shkollën fillore 'Nënë Tereza', në Vranidoll të Prishtinës, në nëntor të vitit 1997.

Reka ka përcjell ngjarje të ndryshme deri në përfundim të luftës, dhe në çdo ngjarje është nisur me parimin se duhet të jetë gjakftohtë që të mos përçojë ai ndjenjat e tij në fotografi, por fotografia të përcjell ngjarjen. Pas çdo ngjarje të rëndë, ai ka shpresuar që do të jetë e fundit dhe se puna e tij do të përfundojë, megjithatë ai vazhdon të punojë dhe të shfaq fotografitë e tij në ekspozita të shumta si pjesë e historisë.

Hazir Reka një pjesë të materialit e ka në pronësi të agjencisë Reuters për të cilin ka punuar njëzet vjet, pjesën tjetër e mbanë në arkivin e tij personal. Ai ka hapur dhjetëra ekspozita në Kosovë dhe jashtë vendit përmes të cilave ka treguar një pjesë të historisë së Kosovës.

'Fotografitë e mia duhet të shërbejnë që të njihet historia, të mbahet mend, të mos harrohet ajo çka ka ndodhur dhe të mos përsëritet kurrë'.



Erëmirë Krasniqi  
Recension Ekspozite

JO NJË VIKTIMË  
PASIVE:

180

181

RRËFIMI I 1133  
FËMIJËVE

Midis vitit 1998 dhe 2000, një numër i madh i fëmijëve në Kosovë i janë nënshtuar dhunës. Siç e tregojnë dëshmitë, në këtë periudhë dyvjeçare në kushte të luftës janë vrarë 1133 fëmijë.

9  
Konventat e Gjenevës [1949] dhe Protokollet e tyre Shtesë [1977], Konventa për të Drejtat e Fëmijëve [1989] dhe Protokolli i saj opsional mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura [2000] dhe Statuti i Romës [1998] i Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

182

183

Kur dhuna dhe lufta zëjnë vend, fëmijët kursehen nga terrori dhe vdekja. Traktatet ndërkombëtare, konventat,<sup>9</sup> dhe dispozitat e ligjeve vendore e obligojnë mbrojtjen e fëmijëve. Megjithëse janë krijuar për të mbrojtur fëmijët, ato nuk kanë gjithherë sukses në garantimin e sigurisë gjatë konflikteve të armatosura dhe luftërave. Midis vitit 1998 dhe 2000, një numër i madh i fëmijëve në Kosovë i janë nënshtuar dhunës. Siç e tregojnë dëshmitë, në këtë periudhë dyvjeçare në kushte të luftës janë vrarë 1133 fëmijë.

Përgjatë historisë së regjistruar, fëmijët kanë qenë së bashku me të rriturit dhe njësoj i kanë vuajtur pasojat dhe kanë rënë si viktimë të luftës. Përjetimet e luftës nga ana e fëmijëve asnjëherë nuk i informojnë narrativat e mëdha historike dhe shpesh herë janë të vendosur jashtë historisë. Historitë e tyre neglizhohen dhe heshten, dhe përvojat e tyre mbeten të papara dhe të padëgjuesha. Duke mos i vlerësuar përvojat e tyre, shoqëritë me [pa] dëshirë, përfshirë këtu edhe Kosovën, vendosin se çfarë lloji të kujtesës do të formësojnë narrativat dominuese të luftës.

Lufta lë gjurmë të dendur në kujtesë. Kujtesa është e mangët dhe rrëmujë në vetëvete dhe, megjithatë i nënshtrohet proceseve shoqërore dhe formësohet nga forca të ndryshme shoqërore dhe komunitetet e kujtesës. Ajo që shoqëritë vendosin të mbajnë mend dhe të kujtojnë dhe keqkujtojnë është një proces kulturor dhe politik, i

cili i lë gjurmët e veta në mënyrën se si anëtarët e saj i rrëfejnë historitë e tyre personale dhe i shkruajnë historitë e tyre zyrtare. Si një kompleks i marrëdhënieve të ndërlikuara dhe të ndërthurura, kujtesa ushqehet nga këto procese, dhe struktura e saj i reflekton këto dinamika shoqërore.

Derisa kujtesa individuale kap nuanca të ndryshme dhe merr shënime mbi luftën e grave, vuajtjet e fëmijëve dhe të të moshuarve gjatë luftës, historia publike dhe infrastruktura e saj përkujtimore vë në qendër historinë ushtarake, e cila thekson trimërinë e disave të përfshirë në luftë. Përderisa, përvojat e fëmijëve të vrarë në luftë nuk artikulohen përmes praktikave përkujtimore, pasi që vendi i tyre në histori është i viktimës pasive, dhe kjo shpesh i privon ata nga të pasurit fuqi dhe zë në formësimin e rrëfimeve dominuese të luftës.

Më shpesh sesa jo, rrëfimet e luftës nuk kanë aftësinë për të njohur të vërtetat dhe dimensionet e shumta të përvojës njerëzore. Deri më tash, në Kosovën e pasluftës, reprezentimi i luftës ka qenë njëdimensional, i treguar përmes përvojës së burrave të militarizuar, historitë e të cilëve janë hedhur në bronz në të gjithë Kosovën. Megjithëse, ato zëjnë një vend të rëndësishëm në rrëfimin për çlirimin, ato nuk arrijnë të gjenerojnë reprezentime të një identiteti kolektiv.

Në vendet me të kaluar të trazuar, muzetë kombëtarë që gëzojnë një shkallë

të kënaqshme të autoritetit në prodhimin e dijes lokale, zakonisht bëhen rrëfyes të së kaluarës së tillë. Në Kosovë, ekspozitat e përkohshme vihen në shërbim për të luajtur këtë rol. Ekspozita si një vend i krijimit të kuptimit bëhet një vend kujtimi dhe përkujtimi, por edhe vend që trajton trashëgiminë e errët të luftës. Ekspozita e bazuar në hulumtim, “Na ishte një herë që kurrë mos goftë”, me kuratore Blerta Hoçia, e hapur më 13 maj 2019 në Qendrën e Dokumentimit të Kosovës (QDK) në Prishtinë, për më shumë se një vit, ka siguruar një hapësirë meditimi për të përkujtuar jetën e 1133 fëmijëve të humbur si pasojë e luftës.

Ambienti narrativ i ekspozitës është i rëndësishëm për shkak të asaj që zbulon në lidhje me reprezentimet e luftës. Asnjëherë më parë në Kosovë lufta nuk është prezantuar përmes përvojës së fëmijëve. Objektet e ekspozuara në ekspozitën “Na ishte një herë që kurrë mos goftë” janë gjëra personale të fëmijëve. Për aq sa kanë vlerë si burime historike, ato gjithashtu rrëfejnë intimisht mënyrën se si u vranë fëmijët në luftë. Për më shumë, duke i përkujtuar ata përmes artefakteve të tyre personale, gjësendet e tyre bëhen mjete që krijojnë identifikim dhe solidaritet të ndërsjellë midis familjeve përgjatë ndarjeve etnike, të cilave iu janë vrarë fëmijët në rrethana të ndryshme të luftës.

Pavarësisht nga rrethanat e vështira, kanë mbetur fare pak gjurmë të prekshme për të treguar historitë e tyre. Anëtarët e familjeve të fëmijëve të vrarë kanë arritur të ruajnë diçka prej tyre për t'i kujtuar ata dhe i kanë ndarë rrëfimet e tyre me Fondin për të Drejtën Humanitare – Kosovë [FDHK]. Dëshmitë gojore të dokumentuara përdoren për të i narrativizuar artefaktet personale të fëmijëve. Ato zbulojnë përvoja komplekse dhe të dallueshme, si dhe flasin për sfidën e të qenit fëmijë në rrethana të dhunshme.

Ndërsa ekspozita merret me një histori të vështirë, vet ekspozita është një histori rreth vështirësisë së krijimit të reprezentimeve të përvojës së fëmijëve në kontekste të dhunshme. Për shkak të efekteve shkatërruese të luftës, pjesa më e madhe e anëtarëve të mbijetuar të familjeve të viktimave nuk kishin shtëpi për t'u

kthyer. Duke i pasur shtëpitë e tyre të djegura, ishin zhdukur albumet e fotografive familjare, dhe gjësende të tjera përkujtuese që mundësonin tregimin e historisë së familjes tyre. Megjithëse, FDHK ka siguruar bashkëpunim të plotë me anëtarët e familjeve të viktimave, ekspozita has në vështirësi të sigurimit të gjësendeve që aktivizojnë kujtesën dhe mbartin kuptimin.

Si një vend përkujtimi, ekspozita mbanë distancë nga reprezentimet e fëmijëve vetëm si viktimia pasive. Ky parim informon strategjitë e ekspozitës dhe vendimet kuratoriale gjatë gjithë kohës. Si e tillë, ekspozita është e vetëdijshme se viktimizimi i fëmijëve mund të kufizojë aftësinë e vizitorëve për të kuptuar përvojat e tyre të jetuara dhe të mohojë fuqinë që artefaktet personale të fëmijëve kanë për të treguar histori kolektive. Megjithëse vdekja qëndron në themel të dyzet e një historive jetësore të ekspozuara, përqendrimi në vdekjen e tyre do t'i reduktonte ata në një ngjarje të vetme: në fundin e tyre.

Dyzet e një objektet e ekspozuara në ekspozitën “Na ishte një herë që kurrë mos goftë” gjurmojnë përmes një shumësie zërash aspekte të shumta të luftës, ndërsa në të njëjtën kohë shënjojnë përdoruesit e tyre të munguar. Përmes një prezantimi mjaft të thjeshtë të objekteve të mbyllura në kuti qelqi dhe druri, objektet e ekspozitës shogërohen me emërtime të shkurtra që shpjegojnë rrethanat e luftës, në të cilat kanë vdekur përdoruesit e këtyre objekteve. Teksti përcjellës i artefakteve personale katalogjizon vdekjet e fëmijëve dhe ia del të tërheq vëmendjen e vizitorëve për t'u angazhuar nga afër me historitë e tyre. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve vdekjet e fëmijëve nuk kanë autorë.

Kjo trashëgimi e errët e luftës është neglizhuar thellësisht për faktin se Kosova dhe Serbia janë të përfshira në një konflikt të ngrirë, i cili deri më sot nuk është zgjidhur. Sistemi ligjor, si ai kombëtar, ashtu edhe ai ndërkombëtar, vazhdojnë të dështojnë në adresimin e mangësive të tyre. Mungesa e vullnetit politik për t'u marrë me të kaluarën e dhunshme ka bërë që të mbizotërojnë një klimë e pandëshkueshmërisë, duke krijuar kështu pengesa për sjelljen e autorëve të krimit para drejtësisë.

10 Masakra e Suharekës i referohet vrasjes masive të civilëve shqiptarë të Kosovës të kryer nga oficerët e policisë serbe në datën 26 mars të vitit 1999 në Suharekë, Kosovë. Ishin dyzet e tetë viktimia të masakrës së Suharekës, duke përfshirë katërmbëdhjetë fëmijë nën moshën 15 vjeç. Dyzet e gjashtë ishin anëtarë të familjes Berisha. Dy gra dhe një fëmijë i mbijetuan masakrës, përkatësisht Gramoz Berisha së bashku me nënën dhe me tezen e tij.

11 Varrezat masive në Batajnicë u zbuluan në vitin 2001 dhe 2002, ku gati mijëra kufoma të shqiptarëve të Kosovës u gjetën të varrosur. Viktimat ishin gra, fëmijë dhe të moshuar, të gjithë civilë. Pas një gjykimi tre-vjeçar, në vitin 2006 Gjykata Speciale e Krimeve të Luftës i gjeti fajtorë katër ish-police për masakrën. Shefi i policisë së Suharekës, Radojko Repanović, dhe oficeri i policisë Slagjan Cukarić u dënuan me 20 vjet burg për përfshirjen e tyre. Oficeri i policisë, Miroslav Petković, dhe zyrtari i sigurimit të shtetit, Millorad Nisavić, u dënuan me 13 përkatësisht 15 vjet.

Nga 1133 raste të fëmijëve të vrarë në Kosovë gjatë luftës, ekspozita sjell tregimet e dyzet e një fëmijëve, dhe vetëm për katër raste mund të pohohet me siguri se kush janë kryerësit, sepse ata janë gjykuar. Megjithëkëtë, gjyqet u kanë dhënë përgjigje të pjesshme familjarëve në lidhje me rrethanat në të cilat të dashurit e tyre kanë vdekur.

Në mesin e fare pak rasteve, që e morën vëmendjen ligjore, është masakra e Suharekës<sup>10</sup> në Kosovë. Kufomat e viktimave janë gjetur në varrezat masive të Batajnicës<sup>11</sup> afër Beogradit, Serbi. Dëshmia e Gramoz Berishës, i mbijetuar i masakrës në Suharekë, është pjesë e ekspozitës. Është rrëfimi i vetëm në vetën e parë që vizitori ndesh në hapësirën e ekspozitës.

Historitë e fëmijëve të tjerë janë rindërtuar përmes anëtarëve të familjes dhe burimeve të tjera dytësore. Për shkak të peshës së një dëshmie të tillë të fuqishme, audio e Gramozit është instaluar në një dhomë të izoluar që të kujton hapësirat medituese brenda muzeve të Holokaustit. Dhoma e Gramozit i siguron vizitorit një moment reflektimi dhe kohe për të përpunuar historitë e fëmijëve të tjerë të cilët fatkeqësisht nuk e ndanë fatin e tij.

Ekspozita e bazuar në artefakte personale “Na ishte një herë që kurrë mos goftë”, duke sjellë histori të lidhura me përvojat personale të fëmijëve, zgjon bashkëndjesi për fëmijët, jeta e të cilëve ishte kurthuar në kompleksitetin e luftës. Përderisa gjestikulon drejt monopolit të kujtesës, ekspozita ofron një kundër–narrativë ndaj reprezentimeve të fëmijëve në luftë si viktimia pasive. Duke vepruar kështu, lokalizon subjektivitetin e fëmijëve, u jep validitet përvojave të tyre jetësore, dhe në këtë mënyrë i rivendosë ata në histori.

Më poshtë mund t'i gjeni  
të gjithë emrat e fëmijëve të  
vrasë dhe/apo të zhdukur në  
ngjarjet e përmendura  
në katalog.

# INDEKSI I EMRAVE

1  
Obri e Epërme  
26.09.1998  
Jeton Deliu, Menduhije Deliu,  
Dituniye Deliu, Antigona Deliu,  
Donjeta Deliu, Gentiana Deliu,  
Mihane Deliu, Valmir Deliu.

2  
Prekaz i Poshtëm  
05.03.1998  
Avdullah Jashari, Bujar Jashari,  
Blerim Jashari, Hanife Jashari.

3  
Poklek i Vjetër  
17.04.1999  
Shehide Muqolli, Naser Muqolli,  
Ylber Muqolli, Egzon Muqolli,  
Eronitë Muqolli, Fatos Muqolli,  
Florentina Muqolli, Hafije Muqolli,  
Lirie Muqolli, Agron Muqolli,  
Albulena Muqolli, Avdullah Muqolli,  
Fatmira Muqolli, Kushtrim Muqolli,  
Mendohije Muqolli, Mergim Muqolli,  
Mirsad Muqolli, Qendrim Muqolli,  
Rexhep Muqolli, Vahide Muqolli,  
Besart Carraku, Hasan Carraku,  
Kujtim Elshani, Nderim Elshani.

4  
Korishë  
13.05.1999  
Arbnore Ahmetaj, Saranda Ahmetaj,  
Agon Ahmetaj, Arben Ahmetaj,  
Arbëresha Ahmetaj, Arbesa Ahmetaj,  
Arbnor Ahmetaj, Ardor Ahmetaj,  
Doruntina Ahmetaj, Egzon Ahmetaj,  
Florentina Ahmetaj, Leotrim Ahmetaj,  
Rinor Ahmetaj, Valon Ahmetaj,  
Vlora Ahmetaj, Valbone Bajselmanaj,  
Përparim Dakaj, Teuta Dakaj,  
Afron Kukaj, Ahmet Kukaj,  
Alban Kukaj, Bledion Kukaj,  
Burim Kukaj, Florinde Kukaj,  
Nysret Kukaj, Sherife Kukaj,  
Avni Suka, Fatjon Suka, Fitim Suka,  
Lumnije Suka, Rezarta Xhaferi,  
Saranda Xhaferi.

5  
Lluzhan  
01.05.1999  
Nikola Petrović, Marija Petrović,  
Arjeta Kopalla, Florinda Kopalla,  
Mirjeta Kopalla, Xhavit Kopalla,  
Besarta Ramadani, Muzaferë Ramadani,  
Bislim Ramadani, Besnik Ramadani,  
Besa Ramadani.

6  
Suharekë  
26.03.1999  
Altin Berisha, Dafina Berisha,  
Dorentina Berisha, Drilon Berisha,  
Edon Berisha, Eron Berisha,  
enc Berisha, Granit Berisha,  
Hanumshahe Berisha, Herolinda Berisha,  
Ismet Berisha, Kushtrim Berisha,  
Majlinda Berisha, Merita Berisha,  
Mirat Berisha, Redon Berisha,  
Sherine Berisha, Vlorian Berisha,  
Zana Berisha.

7  
Domanek  
04.05.1999  
Donjeta Krasniqi, Besa Abazaj,  
Afrim Morina, Lumni Morina,  
Blerta Toplana.

8  
Nagavc  
02.04.1999  
Adelina Berisha, Njomëza Berisha,  
Shkurtesa Berisha, Lezie Berisha,  
Elhame Berisha, Dafina Berisha,  
Valmira Berisha, Shqipron Berisha,  
Valon Berisha, Atdhetar Berisha,  
Albulena Berisha, Sahime Berisha.

Botuar nga  
Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

Për të vizituar ekspozitën në mënyrë  
virtuale, ju lutemi skanoni kodin.

Kuruar nga  
Blerta Hoçia



Teksti i ekspozitës nga  
Blerta Hoçia

Recension ekspozite nga  
Erëmirë Krasniqi

Katalogimi në botim-[CIP]  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Fotografitë nga  
Majlinda Hoxha

77:017[496.51]

Dizajni Grafik nga  
Nita Salihu Hoxha-Permanent

Na ishte një herë që kurrë mos qoftë / Fondi për të  
Drejtën Humanitare Kosovë. - Prishtinë : Fondi për  
të Drejtën Humanitare Kosovë [FDHK], 2020. - 200 f.  
: ilustr. me ngjyra ; 20 cm.

Vizatimet në libër  
Mira Hoxha

ISBN 978-9951-8989-7-3

Intervistat me  
Imer Deliu  
Enver Lipaj  
Rrahime Lipaj  
Dragiša Petrović  
Zorica Petrović  
Isak Asllani  
Hazir Reka



190

191

Mbështetur nga  
Forum ZFD  
National Endowment for Democracy [NED]

Shtypi nga  
Shtypshkronja sh.p.k  
Tirazhi: 500

© 2020  
Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

[hlc-kosovo.org](http://hlc-kosovo.org)





NË KUJTIM TË  
1133 FËMIJËVE  
TË VRARË SI  
PASOJË E LUFTËS  
NË KOSOVË  
1998–2000

1024 FËMIJË  
TË VRARË  
109 FËMIJË  
TË ZHDUKUR